



ALEANCA PËR ARDHMËRINË E KOSOVËS
ALLIANCE FOR THE FUTURE OF KOSOVO

PROGRAMI ZGJEDHOR

2021-2025



ALEANCA PËR ARDHMËRINË E KOSOVËS
ALLIANCE FOR THE FUTURE OF KOSOVO

PROGRAMI ZGJEDHOR

2021-2025

Prishtinë, 2021



RAMUSHI 2021
PER PRESIDENT

Fjala e Kryetarit

Të dashur qytetarë,

Duke qenë se Kosova e tre-ekatër viteve të fundit është gjendur para sfidave të rrezikshme, Aleanca është detyruar të përballet dhe t'u përgjigjet këtyre sfidave, duke paguar çmim të lartë. Së këndejmi jemi në zgjedhje të jashtëzakonshme dhe para vetes e kemi edhe zgjedhjen e presidentit, që këtë herë është çelësi i vlefshmërisë së zgjedhjeve.

Dështimi e eventual i zgjedhjes së Presidentit në Kuvendin e Kosovës është dështim i tërë procesit zgjedhor dhe vendi duhet të shkojë në zgjedhje edhe një herë, që do të ishte dështimi më i madh i klasës politike.

Si lider i Aleancës, në cilësi të Kryeministrit të Kosovës, për t'iu shmangur ideve të rrezikshme që nxirrreshin në tavolinat formale e joformale diplomatike, prej Nishit e deri në Bruksel, më është dashur të sakrifikoj shumë kohë e energji, në përmbysjen e këtyre ideve. Pra, edhe të paguaj çmimin personal dhe të dorëhiqem nga pozita e Kryeministrit.

Taksa 100% në mallrat e Serbisë i acaroi shumë çarqe të vendimmarrjes politike, por ajo ishte e vetmja rrugë për përmbysjen përfundimtare të idesë së ndarjes së vendit.

Aleanca, strukturat e saj, anëtarësia dhe simpatizantët më kanë mbështetur atëherë dhe sot, në mbrojtje të interesave kombëtare dhe shtetërore, duke qëndruar të panënsbtruar në krab të Kosovës së 17 shkurtit, në kufijtë ekzistues.

Prandaj, në rrethanat aktuale, Aleanca e ka rimenduar dhe rivalorizuar programin e saj politik, duke ndërtuar strategji të re për t'iu përgjigjur rreziqeve gjeopolitike, duke investuar në forcimin e mekanizmave të sigurisë, forcave të armatosura dhe inteligjencës, përdërisa në rrafshin ekonomik kemi konceptuar një plan rimëkëmbjeje dhe zhvillimi ekonomik, duke propozuar një fond prej një miliard euro (plan i përcjellë me studim fiskal) për ringjalljen e ekonomisë së vendit nga pandemia. Dhe, këtë program zgjedhor, Aleanca synon ta jetësojë përmes një liste kandidatesh të jashtëzakonshëm me integritet moral e profesional.

Në këto rrethana, kam ofruar kandidaturën time për President, i bindur se kam një ofertë unike për Kosovën, që konsiston në arritjen e unitetit politik dhe sigurisë së brendshme, partneritetit të qëndrueshëm e serioz me aleatët tanë strategjikë, duke siguruar anëtarësim në NATO dhe integrim në BE. Kjo ofertë jona garanton stabilitet politik dhe strategji të re përballë Serbisë. Natyrisht në bashkëpunim dhe bashkërendim të plotë me SHBA-të dhe aleatët evropianë. Ne garantojmë mbrojtjen, fuqizimin dhe avancimin e interesave të qytetarëve dhe shtetit, mbështetur në betimin tonë në Zot dhe Atdhe!

Na priftë e mbara dhe dalshim faqebardhë!

Pomir Haxhiu

Përmbajtja

Ekonomia

Siguria dhe sundimi i ligjit

Mirëqenia

Politika e jashtme



Programi Zgjedhor i Aleancës

2021-2025

Ëndrra e gjeneratave të tëra ka qenë liria dhe pavarësia e Kosovës. Tashmë, është koha e rimëkëmbjes, zhvillimit, sigurisë dhe fuqizimit. Koha për të jetuar me dinjitet e siguri, me pasuri, begati dhe perspektivë. Kosova kërkon udhëheqje të re, dinamike, zhvillimore, kompetente, vendimmarrëse, të fuqishme, të pakompromis ndaj të këqijave dhe të palëkundshme për të mirën e qytetarit dhe të interesave të shtetit. Asgjë nuk na ndalë të punojmë për Kosovën. Askush nuk do të përjashtohet për të bërë diçka të mirë për Kosovën.

Në qendër të programit tonë është rimëkëmbja dhe zhvillimi ekonomik, siguria dhe shteti i së drejtës, mirëqenia dhe politika e jashtme, si parakushte për avancim të pozitës së secilit qytetar dhe shtetit të Kosovës.

Ky program është baza për Kosovën e mbrojtur, të sigurt, të paprekshme, të konsoliduar, të zhvilluar dhe integruar në familjen e shteteve demokratike. Programi ynë bazohet në katër shtylla: Ekonomia, Siguria dhe Shteti i së Drejtës, Mirëqenia dhe Politika e Jashtme. Shtylla e parë garanton rimëkëmbje dhe zhvillim të përshpejtuar ekonomik. Për ta ndërtuar një shtet që është në funksion të një jete më të begatë dhe më të sigurt për të gjithë qytetarët. Kosovës i duhet një zhvillim i hovshëm ekonomik. Kosova do të fillojë të gjenerojë më shumë vende pune, të ketë buxhet më të madh dhe ta rrisë cilësinë e jetës së qytetarëve të vet.

Shtylla e dytë, Siguria dhe Shteti i së Drejtës është koncept i ndarë në dy nënshtylla të cilat ofrojnë garanci për funksionimin e shtetit të sigurt e në përputhje me ligjin. Jemi në rresht me shtetet demokratike për liri dhe për paqe. Kemi bërë ushtrinë dhe tani Kosova do të bëhet partner serioz për rajonin dhe botën demokratike. Sundimi i Ligjit është prioritet kryesor i qeverisjes. Për të fuqizuar Kosovën çdo gjë fillon me një sundim të fortë të ligjit. Mirëqenia si shtyllë e tretë, ngërthen në vete politikat që synojnë përparimin, përmes zhvillimit të shëndetësisë e arsimit, mbrojtjes së të rinjve e të moshuarve dhe krijimin e harmonisë për një jetë të dinjitetshme. Aleanca është promotor i lirisë, barazisë, begatisë dhe jetës prosperuese në vend.

Shtylla e katërt Politika e Jashtme është e kornizuar si reflektim i nevojave të vendit, në funksion të ndërtimit, ruajtjes e thellimit të marrëdhënieve me partnerët tanë strategjikë dhe me shtete të tjera, ruajtjes së sovranitetit, integritetit territorial, rendit kushtetues, lirive dhe të drejtave të qytetarëve të Kosovës brenda dhe jashtë vendit dhe garantimit të sigurisë së saj shtetërore.



Ekonomia

Zhvillimi ekonomik para së gjithash dhe mbi të gjitha është bashkërendim i politikave sektoriale. Politikat institucionale e shtetërore që kanë të bëjnë me ekonominë duhet ta ndjekin një vizion të qartë, por edhe të kenë qasje gjithëpërfshirëse, për shkak se ekonomia është sistem i ndërlidhur. Kështu prej infrastrukturës e deri te planifikimi hapësinor, prej ndarjeve buxhetore e deri te arkitektura ligjore, duhen të jenë në vijë me vizionin afatgjatë ristrukturues.

Ekonomia e Kosovës, përkundër zhvillimeve të shumta pozitive, ka çaluar për një kohë të gjatë nga mungesa e vendimeve vizionare e të guximshme. Hapja e trasesë së re zhvillimore, ristrukturuese të ekonomisë kërkon, krahas qartësisë edhe guximin për t'i bërë hapat e duhur e të vështirë, por edhe energjinë për t'i menaxhuar sfidat. Këta hapa të propozuar në këtë program e vendosin Kosovën në binarë të pakthyesëm drejt zhvillimit të hovshëm e të qëndrueshëm, duke e transformuar në mënyrë të plotë strukturën aktuale ekonomike për t'ia përshtatur atë dinamikës së shpejtë të zhvillimeve globale ekonomike. Kjo është e domosdoshme në mënyrë që ekonomia jonë të përmirësojë konkurrueshmërinë e vet.

Kriza shëndetësore e pandemisë Covid-19, e veçanërisht ajo ekonomike e sociale, e ka dëshmuar më së miri nevojën për udhëheqje të qëndrueshme, të vendosur e vizionare. Kohërat e krizës ekonomike e sociale, sikur kjo aktualja, kërkojnë masa të jashtëzakonshme. Frika nga investimet publike në kohë krize e paralizon ekonominë. Në këtë drejtim fillimi i vitit 2020 me qeverinë Kurti vendosi një standard problematik që i kushtoi shumë ekonomisë sonë. Ndalimi i të gjitha investimeve kapitale për një periudhë të gjatë kohore la pasojë të thella në ekonominë tonë, të cilat po i ndiejmë edhe sot.

Aleanca ka konceptuar dy nënshtylla: “Pakoja e Rindërtimit” dhe “Aleanca për Zhvillim”, të cilat paraqesin përmbledhje të masave e politikave ndërhyrëse, të cilat në njërin anë i përgjigjen çështjeve urgjente e akute me të cilat ballafaqohemi aktualisht, ndërsa në anën tjetër shtojnë rrugën që të kalojmë nga rindërtimi në ristrukturim e zhvillim. Përmes tyre, ne krahas mjekimit të simptomave i luftojmë edhe shkaqet e sëmundjes. Kështu arrijmë deri te shërimi i plotë ekonomik.

Kthim prapa nuk mund të ketë! Për vendqëndrim nuk kemi kohë! Duhet të veprojme jo vetëm shpejtë, por edhe vendosmërisht. Zhvillimi është i pa alternativë! Zhvillimi i qëndrueshëm është Aleanca jonë e vetme për Ardhmërinë e Kosovës. Kështu e ngrisim dinjitetin për qytetarët dhe për Kosovën.



PAKOJA PËR RINDËRTIM - (Vaksina ekonomike antiCovid-19)

Analiza e gjendjes aktuale

Pandemia, përveç rrezikimit të shëndetit publik, e ka goditur më së rëndi ekonominë. Viti 2020 paraqet një ndër tkurrjet më të mëdha ekonomike globalisht, e veçanërisht në vendin tonë. Në frontin ekonomik, BPV real ka shënuar rënie prej 7.5% në vitin 2020. Rënia e rritjes ekonomike në shtetet ku kemi prani të madhe të diasporës së Kosovës (-6% në vitin 2020), si dhe kufizimet ndërkombëtare të udhëtimit do t'i kushtojnë Kosovës 6 pikë përqindjeje të BPV-së në të hyrat nga diaspora për vitin 2020. Kjo do të rëndojë efektin negativ në rritje nga rëniet e detyrueshme dhe vullnetare të lëvizjes brenda vendit dhe paqisurisë së shtuar. Të hyrat në buxhetin e shtetit janë për 117 milionë më të ulëta krahasuar me vitin 2019. Në vitin 2019 kemi pasur 1 miliardë e 168 milionë të hyra të mbledhura nga doganat, ndërsa në vitin 2020 kemi 1 miliardë e 50 milion.

Pra kemi rënie prej 117 milionëve, apo 10% më pak.

Si rezultat, afërsisht 55 mijë qytetarë të Kosovës llogaritet ta kenë humbur vendin e punës, ndërsa afërsisht 150 mijë të punësuar nuk kanë pasur pagë të rregullt gjatë vitit. Zyrtarisht 148 mijë të punësuar janë bërë pjesë e pakos emergjente fiskale të qeverisë Kurti, të cilët i kanë marrë nga 170 euro për muajin mars dhe prill në vend të pagave të tyre nga punëdhënësit. Kjo tregon se sa e thellë ka qenë goditja ekonomike nga pandemia, e veçanërisht nga menaxhimi i saj fillestar, i cili e ndali tërësisht ciklin ekonomik në muajin mars deri në qershor, duke e mbyllur komplet vendin. Ne konsiderojmë që ky ka qenë mbi reagim nga paniku i dëmeve ekonomike dhe sociale, të cilat po i ndejmë edhe sot.

Në pjesën e parë të vitit, Kosova ka qenë tërësisht e orientuar në menaxhimin e shëndetit publik, duke anashkaluar e injoruar në masë të madhe sektorin e ekonomisë. Pas qershorit, fokusi është shtuar në rrafshin ekonomik, mirëpo edhe kjo me ngecje e vonesa të mëdha për shkak të qëndrimit refuzues e të papërgjegjshëm të partive politike e deputetëve të caktuar në kuvend. Shtoja kësaj edhe ndalesën e fillimvitit të secilit projekt infrastrukturor e të investimeve publike, vendim ky në kundërshtim të plotë me logjikën ekonomike që duhet ndjekur në kohë krizash.

Ne konsiderojmë që koha e krizës së jashtëzakonshme kërkon masa të jashtëzakonshme. Investimet publike dhe rritja e qarkullimit ekonomik, përmes stimujve qeveritar janë mënyrat e vetme të sanimit të problemeve ekonomike dhe rimëkëmbjes së prodhimit, shërbimeve, punësimit e qarkut ekonomik në përgjithësi.

Ta paramendojmë sistemin ekonomik sikur trupi i njeriut. Aktualisht i është ekspozuar rrezikut të madh nga infektimi. Nëse e lëmë të infektohet ka gjasa që shpëton. Mirëpo rreziku që infektimi të jetë fatal është shumë i madh. Prandaj duhet të ndërhyjmë nga jashtë. Me vaksinë. Që t'i krijojmë antitruapat në ekonomi, që do ta mbrojnë trupin nga infektimi. Vakcina merret një herë. Dhe pastaj je i mbrojtur. Prandaj duhet të mos mendojmë për kursim, e të mos ngurrojmë. Nuk ka gjë më të rëndësishme se shëndeti (në këtë rast i ekonomisë). Dhe për këtë nuk ka çmim.

Masat e propozuara:

Ndërhyrjet publike në ekonomi ndahen në tri shtylla, me gjithsejtë 17 intervenime:

- ✓ Ndihmë për biznese – në formën e kredive të buta;
- ✓ Ndihmë për qytetarët – në formën e transferove;
- ✓ Lehtësira fiskale – ndihmë për biznese dhe qytetarë.

I. NDIHMA PËR BIZNESE

Qëllimi i kësaj ndihme është që të nxitet rritja e vëllimit ekonomik, të ruhen dhe shtohen vendet e punës, si dhe të mirëmbahen të hyrat në buxhetin e shtetit.

- Fondi për Rindërtim Ekonomik – 1 miliard euro
 - o Financohet nga paratë publike
 - ✓ 20% Buxheti i shtetit – 200 milionë euro;
 - ✓ 10% nga Fondet e privatizimit - 100 milionë euro;
 - ✓ 10% nga Fondi i garantimit të kredive - 100 milionë euro;
 - ✓ 60% borxhi publik - 600 milionë euro.
- o Financon kredi për ndërmarrjet e sektorit privat
 - ✓ Grejs periudha dy vjet nga disbursimi i kredisë (kryegjëja dhe interesi);
 - ✓ Afati i kthimit 5-10 vjet pas grejs periudhës;
 - ✓ Tavani i kamatës 3.5%;
 - ✓ Kreditë menaxhohen përmes bankave komerciale;
 - ✓ Diferenca në kamatë dhe kostoja e grejs periudhës mbulohet nga fondi.

- o Orientimi i financimit
- Mbështetje të zhvillimit të ndërmarrjeve prodhuese;
- ✓ Mbështetje të zhvillimit të ndërmarrjeve që eksportojnë (prodhim/shërbim);
- ✓ Nxitje dhe mbështetje për ndërmarrje e projekte që mbrojnë ambientin.
- ✓ Projekte turistike si Brezovica e Borea;
- ✓ Projekte për parqet teknologjike që ndihmojnë në uljen e kostove fikse për eksportues të shërbimeve dixhitale;
- ✓ Ndërmarrjet prodhuese të ushqimit që zëvendësojnë importet;
- ✓ Sektorëve të ndikuar më së shumti nga pandemia siç janë HORECA (hotelet, restorantet, kafiteritë, etj.) dhe ai i transportit, të cilëve do t'u garantohet ri-programimi i kredive ekzistuese nëpër bankat komerciale, duke futur grejs periudhën, koston e së cilës e mbulon fondi.

II. NDIHMA PËR QYTETARË


Qëllimi i kësaj ndihme është që të rritet kërkesa agregate në ekonominë tonë, të sanohen rëndesat sociale të shkaktuara nga tronditja ekonomike, të mirëmbahen dhe shtohen vendet e punës, veçanërisht për grupet më të marginalizuara të shoqërisë (gratë), dhe të ndihmohen punëtorët të cilët e kanë humbur vendin e punës për shkak të goditjes nga pandemia.

- ✓ Transferet financiare që e rrisin kërkesën dhe i adresojnë problemet sociale.
 - o Financohen nga Buxheti i shtetit;
 - o Orientimi i transfereve;
- ✓ 100 euro për çdo qytetar rezident në Kosovë – 170 milionë euro;
- ✓ Një kartelë e veçantë, shpenzimet e së cilës orientohen në prodhime vendore me vlefshmëri prej 60 ditësh prej ditës kur lëshohet;
- ✓ Fushatë vetëdijësuese bashkë me prodhuesit vendor për ulje çmimesh gjatë këtyre 60 ditëve, për ta orientuar konsumin kah prodhimet vendore;
- ✓ Subvencionim i pagës prej 80% për 3 muaj, për secilin punëtor të kthyer në punë, dhe që ka kontratë së paku 1 vjeçare – 60 milionë euro;
- ✓ 50% të pagës, por jo më pak se 170 euro, për secilin punëtor që e ka humbur vendin e punës për tre muaj pas miratimit të këtij vendimi;
- ✓ Subvencionim i shumë prej 150 euro për tre muaj, për secilën grua të punësuar nga data e miratimit të këtij vendimi, me kusht që kontrata të jetë së paku 1 vjeçare dhe paga e plotë të mos jetë nën 270 euro. – 25 milionë euro (mbulon punësimin e 50 mijë grave);
- ✓ Subvencionim prej 40 euro, për secilin fëmijë të regjistruar në kopsht parashkol-lor publik apo privat për vitin 2021 dhe 2022 – 32 milionë euro.

III. LEHTËSIRAT FISKALE

Qëllimi i kësaj ndihme është që të mirëmbahet likuiditeti i ndërmarrjeve.

- ✓ Për një vit prej ardhjes në qeveri në mënyrë graduale e tërë mbledhja e TVSh-së do të bëhet pas shitjes, masë kjo e cila do ta ndihmojë likuiditetin e biznesit;
- ✓ Shtyrja e obligimeve tatimore të vitit 2020, për fillim të vitit 2022, duke hequr ndëshkimet dhe interesin me mundësi të pagesës me këste për industrinë dhe sektorët që vazhdojnë të afektohen drejtpërdrejtë nga masat restriktive antiCovid-19 të qeverisë;
- ✓ Të hyrat nga eksporti, nga mallrat dhe shërbimet lirohen tërësisht nga tatimi në fitim;
- ✓ Shuma në nivel të pagës minimale (170) lirohet tërësisht nga tatimi. Skema progresive tatimore fillon së zbatuari nga 170 euro e tutje me këtë progresion:
 - o 171 – 300 tatohen me 4%
 - o 301 – 500 tatohen me 8%
 - o 500 – tatohen me 10%
- ✓ Tatimpaguesit të cilët paguanë 50% të borxhit të akumuluar të tatimit në pronë deri me 31 dhjetor 2021, lirohen nga të gjitha kamatat dhe gjobat ndëshkuese.



ALEANCA PËR ZHVILLIM – Rruga përpara

Zhvillimi i hovshëm dhe i qëndrueshëm ekonomik i mbështetur në potencialin njerëzor dhe pasuritë natyrore të Kosovës është boshti i programit zgjedhor të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës dhe e përbën pjesën esenciale të fokusit të qeverisjes së Aleancës. Për arritjen e këtij qëllimi, Aleanca do të sigurojë mjedis institucional dhe biznesor, i cili do të mundësojë mobilizim maksimal të potencialit financiar të vendit dhe do të nxisë investimet e jashtme në funksion të zhvillimit.

Në këtë mandat qeverisës do të realizojmë rritje ekonomike me normë 8% deri në fund të mandatit.

E sekuencuar, kjo do të realizohet me normat 4 % në vitin 2022, 5.3 % në vitin 2023, mbi 7 % në vitin 2024 dhe mbi 8 % në vitin 2025, kur projektet e mëdha zhvillimore do të jenë funksionale. Deri në fund të mandatit 2021-2025 Bruto Produkti Vendor (BPV) do të arrijë mbi 8 miliardë euro. Ndërsa të hyrat e përgjithshme buxhetore në vitin 2025 do të arrijnë në 3.1 miliardë euro. Kjo shifër përbën dyfishim të hyrave buxhetore që do të mbështetet në rritjen e BVP-së, luftimin e evazionit fiskal, informalitetit dhe luftimit të krimit ekonomik të organizuar. Këtë rritje e garantojmë pa rritjen e përqindjeve të taksave

Kjo rritje buxhetore e bazuar në zhvillim ekonomik garanton dyfishim të investimeve publike, dyfishim të transfereve sociale dhe garanton dyfishim të pagës mesatare (nga 500 në 1000 EUR) duke siguruar ruajtjen e strukturës buxhetore.

Për realizimin e projeksioneve zhvillimore nevojitet aktivizim i kapitalit të brendshëm dhe të jashtëm privat. Aleanca do të inkurajojë investitorët vendor dhe investimet e jashtme direkte duke siguruar infrastrukturë ekonomike, sundim të rendit dhe ligjit, siguri të plotë për investorët dhe garanci për fitimet e realizuara. Kosova do ta ketë ofertën e vetë të qartë dhe kredibile për të gjithë investorët e mundshëm.

Dinamika e punësimit, sidomos e të rinjve do të stimulohet në të gjitha format e politikave makroekonomike –fiskale, kreditore dhe sistemore. Kjo qasje dhe këto politika garantojnë krijimin e 30 mijë vendeve të punës në vit, duke filluar nga viti 2022.

Përmes këtyre politikave do të krijohen kushte të veçanta lehtësuese për investimet e diasporës sonë në ekonominë e vendit. Drejt këtij qëllimi, në të gjitha komunat do të ndërtojmë zona

industriale me infrastrukturë ekonomike të kompletuar të cilat do t'u jepen në shfrytëzim diasporës dhe investorëve të brendshëm dhe të jashtëm.

Do të strukturohen dhe mobilizohen institucionet ekzistuese si policia, administrata tatimore, doganat dhe agjencionet e pavarura në atë mënyrë që të jenë të afta të mbrojnë bizneset dhe investorët e rinj, të vendit dhe të jashtëm, nga konkurrenca jo-lojale, barrierat burokratike, kushtëzimet dhe pengesat tjera.

Do të eliminohet evazioni fiskal, ekonomia informale dhe krimi i organizuar si pengesa të mëdha drejt zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik, sigurisë në punë dhe stabilitetit buxhetor.

Aleanca do ta ndryshojë strukturën ekonomike të Kosovës. Do të stimulojmë prodhimin e produkteve ushqimore, bujqësore dhe blegtorale. Brenda këtij mandati do të arrijmë që një pjesë të madhe të importit të prodhimeve bujqësore dhe ushqimore ta mbulojmë me prodhime vendore.

Sistemi fiskal dhe buxheti do të pësojnë ndryshime substanciale kualitative dhe kuantitative. Të hyrat tatimore direkte dhe indirekte, tatimi në të ardhurat e korporatave (tatimi në të ardhura personale, tatimi në pronë, TVSH dhe detyrimi doganor), do të arrijnë 2.45 miliard euro para fundit të mandatit qeverisës. Pjesa tjetër e të hyrave buxhetore si të hyra jo tatimore do të rritet mbi 650 milionë euro. Rritja e të hyrave buxhetore do të realizohet përmes zgjerimit të bazës tatimore, eliminimit të evazionit fiskal, zvogëlimit të ekonomisë informale dhe rritjes së aktiviteteve ekonomike investive, prodhuese dhe eksportuese. Nuk do të ketë rritje të normave të tatimeve dhe doganave, por do të ketë zgjerim të bazës tatimore për mbledhje të obligimeve fiskale.

Do ta garantojmë ruajtjen e stabilitetit buxhetor dhe makrofiskal si dhe garantojmë respektim të normativës fiskale. Do të thelojmë partneritetin me Fondin Monetar Ndërkombëtar, Bankën Botërore dhe institucionet tjera financiare ndërkombëtare.

Shpenzimet buxhetore do të orientohen dhe rriten ndjeshëm në subvencionimin e kategorive ekonomike me qëllim të mbështetjes financiare të sektorit privat me theks në bujqësi, për investime të reja dhe krijimin e vendeve të punës.

Investimet kapitale të sektorit publik do të rriten me dinamikë të shpejtë dhe në fund të mandatit do të arrijë në 1.3 miliardë euro në vit. Mbi 30% të investimeve kapitale do të destinohen për ndërtimin e infrastrukturës ekonomike, e cila do të jetë në funksion të zhvillimit dhe rritjes së bizneseve ekzistuese, bizneseve të reja dhe tërheqje të investimeve nga jashtë.

Vëllimi i investimeve në të dy sektorët, publik dhe privat, do të rritet nga viti në vit dhe në vitin 2025 do të jetë rreth 4 miliardë euro. Sektori privat do të jetë bartës i zhvillimit ekonomik dhe do të absorbojë mbi 60 % të investimeve të gjithmbarshme.

Do të sigurohemi që ndërmarrjet e reja dhe ndërmarrjet në investime do të lirohen në tërësi nga pagesa e obligimeve doganore për pajisjet dhe teknologjinë e importuar.

Për mbrojtjen e tyre sezonale do të vendosim taksa mbrojtëse të posaçme të importit.

Për prodhuesit bujqësorë nga buxheti do të rrisim në vazhdimësi fondet për subvencionimin e prodhimeve blegtorale, për pemëtari, perimtari, vreshtari dhe bletari.

Në kuadër të politikave kreditore, duke siguruar efikasitet të rendit dhe ligjit, do të sigurojmë uljen e normave të kamatave për kredi investive duke siguruar nivel të kamatave si në vendet e eurozonës.

Për investime në prodhimtarinë bujqësore, të turizmit, shërbimeve dhe sektorëve propullziv do të krijojmë kushte të favorshme për vija të veçanta kreditore.

Kujdes i veçantë do t'i kushtohet rritjes së performancës së shpenzimeve publike, veçanërisht investimeve.



Energjia

Analiza e gjendjes aktuale

Konsumi i energjisë elektrike në Kosovë shënon rritje të vazhdueshme. Ndërkohë që strategjia energjetike e vendit nuk ka arritur as për së afërmi ta adresojë gjendjen në të cilën jemi, e aq më pak t'i adresojë nevojat energjetike të së ardhmes. Shumë projekte të planifikuara energjetike nuk kanë arritur të realizohen ndërkohë që tregu dhe struktura rajonale dhe Evropiane e prodhimit dhe konsumit të energjisë po ndryshon me një dinamikë të shtuar.

Kërkesa për energji elektrike në vitin 2019 arriti në sasinë prej 6,001 GWh. Kërkesa për energji elektrike është shumë e bazuar në sezonë, pjesërisht si rezultat i ngrohjes elektrike

Sipas parashikimeve deri në vitin 2030, kërkesa për energji elektrike pritet të rritet deri në 20%, e nxitur nga rritja e të ardhurave dhe elektrifikimi gradual i sektorit të energjisë në përgjithësi, duke nënkuptuar kështu shtesë prej 1,200 Gigavat-orë (GWh) në kërkesën vjetore në vitin 2030. Kapaciteti elektrik aktualisht dominohet nga dy termocentrale me linjit, Kosova A (tri njësi, kapacitet neto 432 megavat MW), dhe Kosova B (dy njësi, kapacitet neto 528 MW). Ndërkohë, njëri nga dy termocentralet e linjtit, ai më i vjetri - Kosova A, duhet të mbyllet së shpejti, duke nënkuptuar kështu humbje furnizimi prej 2,100 GWh në vit, bazuar në prodhimin e vitit 2019.

Vitin e kaluar, humbjet në rrjetin e shpërndarjes së tensionit të ulët ishin shumë të larta, 26% (1,378 GWh) nga kërkesa e përgjithshme e rrjetit të shpërndarjes, të ndara në mënyrë të barabartë midis humbjeve teknike dhe “energjisë së pa faturuar”. Disa nga këto humbje u atribuohen vjedhjeve dhe disa konsumit të pa llogaritur të energjisë elektrike në veri të Kosovës (294 GWh).

Sidoqoftë, ky nivel i rritjes së kërkesës mund të zvogëlohet përmes investimeve në rrjet dhe eficiencës së energjisë. Një analizë e Bankës Botërore, tregon një potencial konservativ për kursime shumë të efektshme të energjisë elektrike, ekuivalente me të paktën 1,400 GWh në vit, deri në vitin 2030. Kjo përfshinë kursime prej më shumë se 800 GWh përmes investimeve për t'i zvogëluar humbjet e rrjetit dhe 600 GWh nga investimet në eficiencën e energjisë së ndërtesave. Aktualisht, humbjet në rrjetin e shpërndarjes së tensionit të ulët janë të jashtëzakonshme 26% (1,378 GWh) të kërkesës totale të rrjetit të shpërndarjes, të ndarë në mënyrë të barabartë midis humbjeve teknike dhe “energjisë së pa faturuar”.

Komuniteti i Energjisë, ku bënë pjesë edhe Kosova, kërkon nga vendet e Ballkanit Perëndimor të zbatojnë një mori të direktivave dhe rregulloreve të BE-së lidhur me energjinë, duke përfshirë këtu edhe disa që lidhen me efikasitetin e energjisë dhe energjinë e ripërtëritshme. Termocentralet me linjit në Kosovë sot mesatarisht tejkalojnë kufijtë e lejueshëm të ndotjes deri në 400%. Kjo ndotje është ndër kontribuesit kryesorë të vdekjeve të parakohshme nga sëmundjet kardiovaskulare dhe ato të frymëmarrjes.

Çmimet me pakicë të energjisë elektrike në Kosovë janë të rregulluara. Vitin e kaluar, çmimet për amvisëri ishin mesatarisht 5.68 euro/cent për kWh, më të ulëta se ato të vendeve fqinje.

Qëllimi i masave që propozohen – Përmes këtij programi për energji do ta sigurojmë furnizimin e rregullt me energji elektrike për ekonominë dhe amvisëritë e Kosovës, me kosto të përbalueshme, si dhe ta shndërrojmë sektorin e energjisë në mekanizëm të zhvillimit të qëndrueshëm përmes kombinimit strukturor dhe diversifikimit të burimeve energjetike në përputhje me standardet dhe rregullat e BE-së.

Masat e propozuara:

a. Termocentralet

Dy termocentrale që aktualisht i ka Kosova janë me teknologji të vjetërsuar (Kosova A e ndërtuar në vitet e 70-ta dhe Kosova B në fillim të viteve të 80-ta). Jetëgjatësia e tyre nuk është shumë e madhe. Përderisa Kosova A, ka qenë e planifikuar të mbyllet në vitin 2017, edhe Kosova B, rrezikon që shpejtë të bëhet e papërdorshme;

Ne do t'i ndërtojmë dy termocentrale për të siguruar furnizimin bazë me energji elektrike;

- Termocentrali Kosova e Re me kapacitet 300 MW/h – do të ndërtohet në infrastrukturën ekzistuese të KEK-ut (Kosova B) në komunën e Obiliqit;
- Termocentrali me gaz, me kapacitet 300 MW/h – do të ndërtohet në Rrafshin e Dukagjinit. Kështu do t'i kemi 5256 GWh në vit.

b. Burimet e ripërtëritshme

Viti i kaluar ofroi të dhënat e para të sigurta (hard data) për performancën e burimeve të ripërtëritshme të ndryshueshme në Kosovë. Ishte viti i parë i plotë, i funksionimit të fermave diellore 3 MW/h dhe një ferme me erë 32 MW/h. Ferma e erës performoi me kapacitet të shfrytëzimit 32%, d.m.th., duke gjeneruar energji elektrike ekuivalente me një të tretën e kapacitetit të vlerësuar. Ky kapacitet i shfrytëzimit të energjisë së erës tejkaloi mesataren e Mbretërisë së Bashkuar, si një nga vendet me më shumë erë në Evropë, me 26% në vitin 2018. Të dy fermat diellore arritën kapacitetin e shfrytëzimit prej 16%. Ky kapacitet i shfrytëzimit tejkalon çdo vend në Gjermani, si lider i Evropës për nga kapaciteti i instaluar dhe është në përputhje me vendet si Bullgaria dhe Turqia.

Ne do të funksionalizojmë sektorin e energjisë së ripërtëritshme me synim të arritjes së tavaneve të caktuara nga Kosova dhe nga rregullat e standardet e BE-së, por

njëkohësisht duke u kujdesur që kostoja e energjisë të konsumatori i fundmë të mbetet e njëjtë me synim që të fillojë të ulet viteve në vijim.

- ✓ Investimet në energjinë e ripërtëritshme do të selektohen përmes ankandit publik;
- ✓ Kjo metodë e re do të eliminojë gradualisht tarifat aktuale nxitëse të cilat janë më të larta se sa kostoja e prodhimit të energjisë nga këto burime;
- ✓ Do të krijojmë bazën e nevojshme ligjore për t'i rishikuar licencat tashmë të ndara e të cilat nuk janë funksionalizuar;
- ✓ Në vitin 2021 do të arrijmë të prodhojmë 150 MW shtesë nga burimi i erës;
- ✓ Në vitin 2021 do të arrijmë targetin prej 30 MW shtesë nga burimet fotovoltaike;
- ✓ Do të ndajmë një fond inkurajues për ndërtimin e kapaciteteve të vogla për energji diellore në çati nga prodhuesit rezident dhe komerciale.

c. Efiçienca (retrofiti)

- ✓ Investimi në efiçiençën e energjisë: Investimi në rritje në ndërtesat publike dhe banesore përfshirë ngrohjen qendrore, do të zvogëlojë konsumin kombëtar të energjisë elektrike të Kosovës me rreth 600 GWh deri në vitin 2030, sipas studimit të opsioneve të Bankës Botërore;
- ✓ Investimi në interkoneksion: Vënia e plotë në punë e interkonektorit 400 kV/600 MW në Shqipëri dhe ndërtimi i interkonektorëve të ngjashëm mund të ulin koston e plotësimit të kërkesës, duke lejuar importe që kushtojnë më pak se termocentralet e reja;
- ✓ Investimet në transmetimin dhe shpërndarjen e energjisë elektrike: Sipas Bankës Botërore, humbjet teknike vjetore nga rrjeti i shpërndarjes dhe transmetimit mund të zvogëlohen me 471 GWh në vit, deri në vitin 2030. Banka Botërore vlerësoi se humbjet e rrjetit jo-teknik të shpërndarjes mund të shkurtohen me rreth 350 GWh çdo vit.

Aktualisht janë dy projekte që janë duke u zhvilluar në këtë drejtim.

- Masat për efiçiençë të Energjisë në ndërtesa publike komunale – projekt me kosto prej 8 milionë eurosh që financohet nga Korniza Investuese për BP (3 milionë euro grante), KfW (2.5 milionë euro kredi), dhe shteti gjerman (po ashtu 2.5 milionë euro kredi);
- Masat për efiçiençë të energjisë në ndërtesat publike qendrore – projekt me kosto prej 28.3 milionë euro që financohet nga Korniza Investuese për BP (672 mijë euro grante), dhe Banka Botërore (27.7 milionë euro kredi).

d. Kogjenerimi

Ngrohja qendrore e centralizuar ka përparësi të caktuara krahas ngrohjes në nivel amvisërie, duke përfshirë mos ndotjen e ajrit të brendshëm dhe qasje më të mirë në më shumë burime të energjisë. Kosova ka katër sisteme të ngrohjes qendrore, në Prishtinë, Gjakovë, Zveçan dhe Mitrovicë.

- ✓ Do të ndërtohen edhe katër sisteme në qendrat e mbetura rajonale – Pejë, Prizren, Ferizaj dhe Gjiilan;
- ✓ 154 milionë euro (kombinim mes granteve, kredive dhe financimit vetanak nga korniza për investime për BP, Banka Evropiane për Investim, dhe BERZh-i), janë të ndarra për këtë projekt, ndërsa ai është në përgatitje e sipër.

Industria


Analiza e gjendjes aktuale:

Baza e zhvillimit ekonomik të cilit do vend, është industria. Kështu edhe Kosova bazën e ekonomisë së saj duhet ta ketë të orientuar edhe kah industria. Meqë i kemi resurset, e kemi traditën, e kemi fuqinë punëtore, por edhe pozitën strategjike, zhvillimi i sektorëve të caktuar të industrisë është i domosdoshëm.

Deri sot, që prej çlirimit nga Serbia, ekonomia e Kosovës ka parë zhvillime pozitive në sektorë të caktuar të industrisë. Industria sot përbën afërsisht 20% të Bruto Produktit Vendor, ndërsa punëson afërsisht 20% të fuqisë aktive punëtore. Rritja e produktit industrial në Kosovë ka qenë stabile dhe sillet rreth 1.5% deri në 2%. Kapacitetet industriale të Kosovës janë mjaft diverse për një vend që krahasuar me vendet tjera mund të llogaritet i vogël. Deri tash gati se tërësisht me forca vetanake, këta sektorë të industrisë së Kosovës kanë arritur një zhvillim stabil: industria minerare, ajo e materialit ndërtimor, industria e metaleve bazë, industria e lëkurës dhe tekstitil, industria e makinerisë, si dhe industria e përpunimit të ushqimit dhe pijeve.

Zhvillimet dhe dinamikat evropiane dhe globale ekonomike kërkojnë e kushtëzojnë një transformim ekonomik të sektorit të industrisë për t'iu përshtatur kërkesave në tregjet botërore. Për këtë arsye Kosova nuk duhet të mbetet prapa, por rristrukturimi ekonomik nuk mund të bëhet pa përkrahjen dhe ndihmën e qeverisë. Përkrahja financiare, fiskale, infrastrukturore e arsimore janë të domosdoshme në mënyrë që industrinë tona, ndërmarret tona të jenë në hap me kohën dhe të zhvillojnë konkurrueshmërinë përmes përshtatjes në tregjet globale.

Sektorët e mëposhtëm industrial do të jenë fokus i Qeverisë sonë në katër vitet e ardhme të mandatit qeverisës:



e. Trepça

Deri para vitit 2016, Trepça ishte nën administrimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit. Me miratimin e Ligjit për Trepçën nga Kuvendi i Kosovës në tetor të vitit 2016, ajo themelohet si Shoqëri Aksionare me 80% të aksioneve nga Qeveria e Kosovës dhe me 20% të aksioneve nga punëtorët. Në këtë kuptim, tashmë është krijuar infrastruktura ligjore që do t'i mundësonte Trepçës zhvillim të qëndrueshëm ekonomik duke u hapur rrugë investimeve, rritjes së vlerës së aseteve dhe në avancimin e kapitalit tekniko-teknologjik si parakusht për rivitalizimin e saj.

Ligji i ri, i krijoj tre Njësi Biznesi (NJB) të përbëra nga:

1. NJB1: Miniera me flotacion Stantërg-Tuneli i Parë;
2. NJB2: Miniera me flotacion Artanë-Kishnicë;
3. NJB3: Miniera me flotacion Belo Bërdo dhe Cërnac-Leposaviq;

Më tej, ligji ka mundësuar që të krijohen edhe dy njësi tjera të biznesit që do ta mbulonin Metalurgjinë e Plumbit dhe Metalurgjinë e Zinkut, por edhe me mundësinë që të krijohen edhe të tjera si rrjedhojë e gjetjeve që do të shfaqeshin nga studimi i fizibilitetit dhe analizës së përgjithshme dhe të veçantë ekonomike.

Në fillim të vitit 2019, kuvendi e miratoi edhe Statutin e Trepçës, që i mundësoi asaj të regjistrohej në Agjencinë e Regjistrimit të Biznesve të Kosovës si dhe adresimit të çështjeve kryesore në konstituimin dhe funksionalizimin e saj, sepse ky sektor i minierave edhe më parë, por edhe tani konsiderohet një aset i rëndësishëm në ekonominë e Kosovës, duke e pasur parasysh gjeologjinë e larmishme që e përmban. Po ashtu duke ditur potencialin e saj, të cilin e përbëjnë resurset minerale që vlerësohen mbi 50 mil/t, dhe brezin e saj metalogjenik të shtrirë në një gjatësi prej 80 km me një numër të madh vendburimesh dhe mineralizimeve tjera përcjellëse.

Ky potencial ligjor dhe rregullativ për Trepçën i bashkëdyzuar me potencialin minerar e industrial të Trepçës, krijojnë hapësirën e duhur e të domosdoshme për rivitalizimin e këtij kompleksi dhe kësaj industrie, përfshirë këtu edhe potencialin që do të krijohet për të tërhequr investimet e huaja.

Masat e propozuara:

Për t'i ngritur investimet në Trepçë, në afat prej 4 vitesh, qeveria e udhëhequr nga Aleanca do të ndër marrë këto masa:

1. Duke marrë parasysh se nga minierat e Trepçës nuk kemi produkt final për berzë, është e domosdoshme që të investohet në ndërtimin e elektrolizës së zinkut dhe shkrites së plumbit;
2. Me rregullimin e statutit të Trepçës, asaj i mundësohet që të orientohet në gjetjen e partnerëve strategjik që do të investonin në rivitalizimin e saj, por në të njëjtën kohë duke ruajtur pronësinë publike dhe duke mbajtur sipas ligjit 20% në pronësi të punëtorëve të Kombinatit Trepça;

3. Shfrytëzimi i mundësive kreditore afatgjata nga Banka Kosovare për Investime dhe Zhvillim;
4. Shfrytëzimi i Ligjit për Investime Strategjike për sjelljen e investorëve strategjikë me negociata direkte.

Për t'i joshur investimet e huaja në Trepçë e duke ruajtur interesat pronësore të punëtorëve dhe shtetit, qeveria e udhëhequr nga Aleanca do të ndërmarrë këto masa shtesë:

1. Pushim tatimor në fitim për 3 vite;
2. Pushim tatimor në paga dhe në kontribute për 3 vite;
3. Lehtësim i qasjes në financim / hua për modernizim të teknologjisë së Trepçës duke ofruar garancinë e shtetit.

f. Fasoneritë

Analiza e gjendjes aktuale:

Përderisa industria e tekstilit po globalizohet gjithnjë e më shumë, prodhimi i veshjeve dhe këpucëve në dekadat e fundit, është zhvendosur në vende ku fuqia punëtore është e lirë, kryesisht në vendet aziatike. Tregu global i tekstilit parashikohet të tejkalojë vlerën prej 900.0 miliardë dollarë në fund të vitit 2021, një rritje prej 28.5% që nga viti 2016. Për më shumë, tregu global i veshjeve me pakicë parashikohet të arrijë në vlerë 1,834 miliardë dollarë në 2022, një rritje prej 29.7% që nga viti 2017.

Falë kostove më të ulëta të prodhimit, rrobat janë bërë gjithnjë e më të përballueshme për konsumatorët evropianë. Për vendet në zhvillim, eksportet e tekstilit krijojnë vende pune dhe rritje ekonomike, duke ndihmuar në uljen e niveleve të varfërisë.

Në vitin 2019, 59% e rrobave dhe këpucëve të importuara nga vendet e BE, erdhën nga jashtë BE-së, ndërsa 41% erdhën nga vendet e tjera të BE-së. Në fakt, përqindja aktuale e rrobave dhe këpucëve të shitura në BE, por të prodhuara diku tjetër është shumë më e lartë për produktet e tekstilit është afër 80%.

Përveç Kinës, shumica e importeve të rrobave dhe këpucëve në BE vijnë nga vendet e Azisë. Megjithëse Kina është ende në vendin e parë, pjesa e saj në tregun e modës në BE ka rënë që kur arriti kulmin në 2011, ndërkohë Kamboxhia, Mianmari dhe Bangladeshi kanë parë një rritje spektakolare në eksportet e tyre, veçanërisht Bangladeshi, ku rrobat dhe këpucët përfaqësojnë 89% të eksporteve të saj totale, prej të cilave 56% shkojnë në BE. Shqipëria gjithashtu është shembull prej të cilit mund të marrim informacione dhe mësim për thithjen e investimeve në këtë sektor. Aktualisht, tekstili dhe këpucët janë eksporti më

domethënë nga Shqipëria, duke përfaqësuar rreth 39% të totalit të eksporteve në vitin 2019, me mbi 55 mijë të punësuar.

Pas përhapjes së shpejtë të COVID-19, Kina dhe shumë shtete tjera në Azi, u futën në bllokim ekstrem dhe prodhimi i fabrikave të tekstilit ka rënë në kriza të mëdha prodhimi ose kanë ndaluar prodhimin në tërësi. Shto kësaj edhe faktin që transporti i mallrave gjithashtu u ndalua ose u kufizua në mënyrë drastike.

Kjo mbështetje e zinxhirit të furnizimit në Kinë, nxjerrë në pah një dobësi për shumë biznese të BE-së dhe të SHBA-ve, vende me të cilat Kosova ka marrëveshje preferenciale tregtare.

Për disa kompani, situata si kjo me pandeminë COVID-19, mund të nënkuptojë ndalimin e të gjithë rrjedhës së produkteve të tyre dhe rrjedhimisht humbje e rreziqe të mëdha. Për dallim, kompanitë që prodhimin e tyre nuk e kanë të koncentruar vetëm në një vend, por që prodhojnë në shumë vende, kanë avantazhin strategjik për ta zhvendosur prodhimin e tyre në baza të tjera prodhuese. Kjo ka qenë një strategji e përdorur nga shumë kompani që janë përpjekur të qëndrojnë konkurruese në kohë krizash.

Ndërsa koronavirusi është përhapur globalisht, asnjë vend nuk është i imunizuar nga ndërprerjet e prodhimit dhe transportit që ka krijuar, madje as BE-ja dhe SHBA-të, por kryesore për kompani në këtë industri ka qenë se qëndrueshmëria e zinxhirit të furnizimit është e një rëndësie thelbësore.

Për shumë kompani nuk është çështja e eliminimit të prodhimit kinez, por përkundrazi, diversifikimi i zinxhirit të furnizimit për tu siguruar që nuk i kanë futur të gjitha vezët në një shportë. COVID-19, ka shpërfaqur faktin që kompanitë sot duhet të mbrojnë prodhimin e tyre, duke analizuar të gjitha opsionet dhe duke krijuar një zinxhir furnizimi të fortë dhe fleksibël. Dhe këtu shpërfaqet mundësia për Kosovën!

Kosova ka raporte të privileguara tregtare me BE-në dhe SHBA-të, një forcë të re punëtore me paga konkurruese, ligje të avancuara për mbrojtje të pronës intelektuale, skema tatimore të favorshme dhe kontribute të ulëta të cilat mund të përdoren për të joshur këto kompani që të konsiderojnë Kosovën si destinacionin e tyre të mundshëm për të lëvizur prodhimin nga Azia në vende më të afërta dhe më të sigurta.

Masat e propozuara:

Për të joshur investimet e sektorit privat (të huaj dhe vendor) në industrinë e përpunimit të tekstilit, Qeveria e Kosovës e udhëhequr nga Aleanca do të ndërmarr këto masa:

- 1) Tokë në zona ekonomike / parqe industriale (me infrastrukturë përcjellëse) pa kosto;
- 2) Pushim tatimor në fitim për 5 vite;

- 3) Pushim tatimor në paga dhe kontribute për 3 vite;
- 4) Kredi të butë me garanci të shtetit;
- 5) Financimi i trajnimeve për punëtorët në bazë të nevojave specifike të secilës ndërmarrje.

Për të gëzuar këto benefite, investori (i jashtëm apo vendor) duhet të përmbushë edhe disa kushte që ndërlidhen me rritje eksporti, numrin e të punësuarve dhe trajnimin e tyre, bartjen e teknologjisë dhe dijës dhe paga nuk mund të jetë nën pagën minimale të përcaktuar me ligj.

g. Industria e shërbimeve

Analiza e gjendjes aktuale

Në vitet e fundit, rritja e eksportit prej sektorit të shërbimeve dixhitale dhe kontratave për shërbime në Kosovë, është rritur ndjeshëm për shkak të përparimit në teknologji dhe kapaciteteve njerëzore që ka Kosova. Nënkontraktimi (i jashtëm) i shërbimeve është bërë një nga bizneset më të rëndësishme në kuadër të potencialit për eksport me trende pozitive, dhe ky trend duket se do të vazhdojë edhe për një kohë të konsiderueshme. Me depërtimin më të lartë të internetit në Evropën Juglindore, tregu i TI-së në Kosovë vazhdon të rritet dhe është një mundësi e shkëlqyeshme për nënkontraktimin e shërbimeve të jashtme për kompanitë ndërkombëtare.

Është e qartë që kompanitë gjithandej Evropës, janë duke nënkontraktuar zhvillimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve dixhitale dhe shërbimeve tjera të biznesit në vende tjera, duke e parë këtë kryesisht si një mundësi për të siguruar shërbime cilësore, me kosto më të ulët. Në botën e sotme të ndërlidhur, kjo paraqet një mundësi të jashtëzakonshme, sidomos nëse shteti e trajton këtë industri si një mjet strategjik, që të fuqizojë ekonominë e vendit duke shfrytëzuar mundësitë që po shpërfaqen në zinxhirët evropian e global, për nënkontraktim e kontraktim të shërbimeve e për pasojë të rritë eksportin dhe punësimin në sektorë me vlerë të shtuar.

Gjithnjë e më shumë, bizneset po kërkojnë të transferojnë shërbimet ITO (nënkontraktimi i shërbimeve që lidhen me teknologji të informacionit) dhe BPO (nënkontraktimit i proceseve dhe shërbimeve që lidhen me procese të biznesit) në Evropën Juglindore. Disa nga shembujt e nënkontraktimit të jashtëm, përfshijnë shërbime të TI-së, prodhim dhe zhvillim të softuerit/ programeve, dizajn dhe animacion grafik, shërbime kontabiliteti, shërbime ndaj klientit, qendra thirrjesh dhe funksione të ndryshme të burimeve njerëzore. Në vitin 2017, tregu i nënkontraktimit të shërbimeve të ITO dhe BPO në Evropën Juglindore (EJL), u vlerësua në 7.542 miliardë euro, duke kërcyer çdo vit me 14.9% dhe duke kontribuar 3.3% në BPV-në e rajonit. Ky treg pritet të dyfishojë madhësinë e tij deri në fund të vitit 2021 dhe të kalojë vlerën prej 14 miliardë euro. Në Rumani, kjo industri tashmë është një nga shtytësit kryesor të zhvillimit me 11% pjesëmarrje në BPV-në e

vendit. Bullgaria është një tjetër vend me një prani të fortë të këtij sektori në ekonominë e tyre, duke kontribuar pothuajse afër 10% në BPV-në e tyre. Ky burim i kapaciteteve për punësim e zhvillim është akoma një sektor në zhvillim në ekonominë e vendeve të rajonit, dhe sot numëron mbi 200,000 të punësuar në EJL, prej të cilëve vetëm në Bullgari janë mbi 60,000 të punësuar.

Në këtë trend të rëndësishëm rajonal e global, Kosova është duke u shpërfaqur si një nga vendet kryesore të Evropës për burime globale të shërbimeve të ITO dhe BPO. Ndoshta aspekti më mbresëlënës e konkurrues, posaçërisht për Kosovën është njohuria teknike e fuqisë punëtore e cila është e angazhuar në sektorin e TI-së, kosto më e ulët krahasuar me vende që tashmë janë në hartë, të vendeve që konkurrojnë në këtë industri, dhe numri i madh të personave me arsim/njohur të lartë në TI e njohje të gjuhëve të huaja.

Në këtë kontekst, që ekonomia e Kosovës të integrohet më shpejtë e më thellë në zinxhirin global të këtyre shërbimeve, qeveria e vendit duhet të jetë më aktive me politika infrastrukturore, fiskale dhe ato të lehtësimit të barrës së kostove fillestare.

Masat e propozuara:

Për të rritur konkurrueshmërinë dhe mundësitë e ndërmarrjeve tona në tregun global, Qeveria e Kosovës do të ndërmarrë këto masa:

- 1) Subvencionimin e qirasë deri në 10 milionë euro në vit deri në vitin 2025, për ndërmarrje që eksportojnë shërbime e që krijojnë vende pune të reja dhe kanë mbi 10 punëtorë të kualifikuar në kohën kur aplikojnë për përkrahje;
- 2) Ndërtim i parkut teknologjik prej 15,000 m² me kosto prej 10 milionë euro në Prishtinë për ndërmarrjet mikro dhe të vogla, duke krijuar infrastrukturën fizike dhe teknologjike për ndërmarrjet që ta shfrytëzojnë me kosto minimale, apo pa kosto hapësirën, infrastrukturën teknologjike, koston e komunaleve dhe pajisjet bazë për zyrë;
- 3) Të hyrat nga eksporti për mallrat dhe shërbimet lirohen tërësisht nga tatimi në fitim.

h. Industria e ushqimit (+bujqësia)

Bujqësia ka qenë një sektorë strategjik e tradicional i aktivitetit ekonomik në Kosovë. Të dhënat statistikore e paraqesin atë si një sektorë të rëndësishëm të të ardhurave kombëtare.

Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës vlera e shtuar bruto (dallimi mes prodhimit të përgjithshëm nga industria bujqësore dhe kostos së inputit bujqësor) arriti në 476.9 milionë euro në vitin 2019, e cila përbën rritje prej 18.4%, në krahasim me vitin 2018. Vlera e shtuar neto (prodhimi i përgjithshëm nga industria bujqësore, minus shpenzimet e konsumit të ndërmjetëm dhe konsumi i kapitalit fiks) arriti në 360.3 milionë euro në vitin 2019, e cila përbën rritje prej 22.4%, në krahasim me vitin 2018. Të ardhurat sipërmarrëse (shuma e vlerës së shtuar neto, plus subvencionet në prodhim, minus kompensimi për punëtorët, taksat mbi prodhimin, qiratë dhe interesi i kredive) kanë rritje me 22.5% në vitin 2019, në krahasim me vitin 2018.

Në vitin 2019 në sektorin e bujqësisë llogaritet të kenë qenë të punësuar gjithsej 270,000 persona, ku përfshihen bartësit e bizneseve bujqësore, familjarët e angazhuar, të punësuarit e rregullt dhe ata sezonal.

Në Kosovë sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore është 420,141.05 hektarë (përfshirë tokën e përbashkët). Nga gjithsej sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore, pjesa më e madhe u përket: livadheve dhe kullosave (përfshirë tokën e përbashkët) me 51.9%, tokës së punueshme, ku arat marrin pjesë me 44.8%, kulturat shumëvjeçare (pemët, vreshtat, fidanët) me 3.0% dhe kopshtet me 0.3%.

Sipërfaqja e ujitur, të paktën një herë gjatë vitit është 31,000 hektarë, kurse, gjithsej sipërfaqja e trajtuar me pesticide është 19,000 hektarë.


Kosova ka shënuar një rritje edhe të industrisë së përpunimit të ushqimit. Sektori i përpunimit të ushqimit bashkë me prodhimin bujqësor paraqesin afërsisht 18% të eksportit të gjithmbarshëm të Kosovës, ndërsa përbëjnë afërsisht 20% të Bruto Produktit Vendor.

Në mënyrë që ta mirëmbajmë e rrisim këtë sektor, qeveria jonë do të fokusohet në tre rrafsh kryesore:

- 1) Ndërlidhjen më funksionale të produktit primar bujqësor me industrinë e përpunimit të ushqimit – industrializimi i bujqësisë;
- 2) Riorientimin e subvencioneve publike për këtë sektor kah produkti dytësor për ta siguruar kështu rritjen e prodhimit industrial;
- 3) Zgjerimin e kapaciteteve e rritjen e cilësisë së prodhimeve për të siguruar hapësirë më të gjerë në tregun vendor e rajonal.

Masat e propozuara:

- 1) Rritja e shumës dhe efektshmërisë së subvencioneve financiare;
- 2) Sigurimi i formave shtesë të financimit (kredi të buta, etj.);
- 3) Zhvillimi i skemës së subvencionit të prodhimit dytësor që do të rriste përdorimin e produkteve vendore bujqësore në fabrikat e përpunimit të ushqimit;
- 4) Investim në zgjerimin e zinxhirit të vlerës brenda ekonomisë sonë;
- 5) Angazhim në eliminimin e të gjitha barrierave jo tarifore që vendosen nga vendet rajonale karshi prodhimeve tona ushqimore;
- 6) Subvencionim të kostos së garancive bankare për sektorin e bujqësisë dhe përpunimit të ushqimit;
- 7) Investimet në infrastrukturë do të kontribuojnë në uljen shtesë të kostos së transportit të produkteve bujqësore;
- 8) Investim në përmirësimin dhe standardizimin e cilësisë së produkteve ushqimore.
- 9) Bashkë me institucionet arsimore do t'i orientojmë qytetarët drejt rritjes së kapaciteteve kadrovike në sektorin e prodhimit të ushqimit (teknolog të ushqimit, veterinar, agronom, etj.);
- 10) Do të investojmë në rritjen e bashkëpunimit mes prodhuesve bujqësor për ta shtuar kështu rendimentin dhe përfitimin për secilin prej tyre.



Infrastruktura

Asnjë vend nuk zhvillohet pa investuar në infrastrukturë dhe kjo është arsyeja pse pas Luftës së Dytë Botërore, vendet perëndimore investuan masivisht në infrastrukturë. Kjo është gjithashtu arsyeja pse vendet që gëzuan zhvillime dhe tranzicione të shpejta pas luftërave si Japonia dhe Koreja e Jugut dhe më vonë Kina, ndërmorën hapa të mëdhenj në investime infrastrukturore për të siguruar një përmirësim drastik në infrastrukturën e tyre, në mënyrë që të sigurojnë parakushtin që “mundëson” rritjen dhe zhvillimin më të shpejtë ekonomik.

Kosova në 15 vitet e fundit masivisht ka investuar në infrastrukturën rrugore, me theks të veçantë në ndërtimin e autostradave. Sipas të dhënave publike, menjëherë pas pavarësisë por edhe viteve të fundit, 1/3 e shpenzimeve publike të buxhetit të Kosovës ka qenë e drejtuar tek investimet infrastrukturore, kryesisht ato rrugore. Këto investime arritën shumë të lartë me ndërtimin e autostradës Kosovë-Shqipëri dhe më vonë me ndërtimin e autostradës që e lidhë Prishtinën me Shkupin. Njëra bëri që Kosovës t’i mundësojë që më mirë, më lehtë dhe më shpejtë, të bëhet pikë e rëndësishme e lidhjes me Detin Adriatik, ndërsa tjetra ishte e rëndësishë së njëjtë socio-ekonomike. Kështu, investimi në infrastrukturën rrugore u konsiderua i rëndësishëm për zhvillimin dhe avancimin e veprimtarive biznesore.

Sidoqoftë, nevojat për investime në infrastrukturë janë ende prezentë dhe ato në disa drejtime. Nevoja për diversifikimin e investimeve në infrastrukturë është e evidente dhe mëse e nevojshme. Infrastruktura rrugore në të cilën duhet të investohet ende për ta përfunduar, i duhet bashkangjitur edhe investimet në infrastrukturën hekurudhore, në rrjetin e gazit si mënyrë e furnizimit me energji, dhe në infrastrukturën teknologjike si bazë për zhvillimin e industrisë digjitale. Të gjitha këto investime infrastrukturore, mundësojnë edhe krijimin e parakushteve të domosdoshme për ristrukturimin e ekonomisë së vendit nga një ekonomi e cila konsumon e importon, në ekonomi që krijon vlerë të shtuar, eksporton dhe punëson.

Qëllimi i investimeve infrastrukturore që propozohen me këtë program do t’i mundësojnë Kosovës që të bëjë kapërcimin e duhur ekonomik dhe t’i siguroj ndërmarrësve të saj

Masat e propozuara:

a) Unaza e gazit

Kosova nuk e ka të ndërtuar infrastrukturën e gazit dhe rrjedhimisht nuk ka as treg gazi. Në vitet që kemi lënë pas Qeveria e Kosovës është shprehur e interesuar për të zhvilluar infrastrukturën e gazit me qëllim që të diversifikoj burimet e energjisë, të jetë e ndërlidhur me rrjete rajonale e globale të gazit, por edhe të sigurojë mundësi zhvillimi të kapaciteteve industriale për vendin.

Për të ndërtuar një infrastrukturë të mirë, të qëndrueshme dhe rentabile të gazit ne do të ndërmarrin këta hapa:

- 1) Zhvillimin e një master plani për lidhje në rrjetet e gazit në rajon dhe shtrirjes së infrastrukturës së gazit së paku në 7 qendrat e Kosovës;
- 2) Sigurimin e marrëveshjes për qasjen dhe zhvillimin e infrastrukturës për t'u lidhur me gazsjellësin Trans Adriatik (TAP), i cili pritet të përfundojë më së voni në vitin 2021;
- 3) Kosova duhet të lidhet me TAP, përmes gazsjellësit që lidhë Kosovën me Shqipëri dhe këtë ta financojë në masën më të madhe nga projektet që i përkrahin investimet e këtilla në Ballkanin Perëndimor (WBIF / BE dhe DFC/SHBA);
- 4) Kosova gjithashtu duhet të rehabilitoj dhe rindërtoj rrjetin e gazit prej Obiliqit në Shkup (Azotiku) dhe degëzimet e saj në Kosovë, në mënyrë që të ketë mundësi të lidhet edhe me rrjetin e shpërndarjes së gazit natyror (LNG), që vjen nga SHBA-ja në terminalin e gazit (LNG) në Greqi;
- 5) Zhvillimi dhe shtrirja e rrjetit të gazsjellësit në 7 regjione të Kosovës.

b) Hekurudhat

Rrjeti hekurudhor në Kosovë duhet të shndërrohet në një nga shtyllat infrastrukturore që do të nxitë shkëmbimet tregtare, duke lehtësuar rritjen ekonomike dhe duke siguruar një lidhje më të mirë për tregti e transport e kësajsoj duke e rritur produktivitetin.

Është imperativë që investimet në rrjetin hekurudhor të bëhen në dy pista të politikave publike dhe investive. E para është ngushtë e ndërlidhur me investimet që kanë filluar të bëhen dhe të cilat po planifikohen në kuadër të iniciativës dhe kornizës me WBIF, EBRD e partnerë tjerë ndërkombëtar. Këto projekte do të përmirësojnë lidhjen ndërmjet rrjetit hekurudhor të Kosovës dhe rrjetit më të gjerë evropian përmes Korridorit VIII Pan-Evropian dhe Korridorit X, drejtë jugut deri në kufirin me Maqedoninë e Veriut dhe në veri deri në kufirin me Serbi. Ndërsa e dyta lidhet me projekte të financuara nga instrumentet shtetërore (buxheti dhe nga mjetet e Bankës Kosovare për Investime dhe Zhvillim), e që ndërlidhen me rehabilitimin dhe modernizimin e rrjetit hekurudhor që i lidhë qytetet e Kosovës.

Për të ndërtuar një infrastrukturë të mirë, të qëndrueshme dhe rentabile të transportit hekurudhor, ne do të sigurohemi që këto projekte të realizohen:

- (a) Rehabilitimi dhe renovimi i linjave që ndërlidhen me rrjete rajonale e ndërkom-bëtare;
 - (i) Rehabilitimi dhe modernizimi i linjës hekurudhore: Fushë Kosovë- Mitrovicë;
 - (ii) Rehabilitimi dhe modernizimi i linjës hekurudhore: Fushë Kosovë-Maqedoni;
 - (iii) Rehabilitimi dhe modernizimi i linjës hekurudhore: Mitrovicë – Serbi.
 - (iv) Rehabilitimi, adaptimi dhe transformimi i linjës hekurudhore: Aeroporti Adem Jashari – Prishtinë;
 - (v) Ndërtimi i rrjetit hekurudhor që lidh Kosovën me Shqipëri, duke ia mundësuar Kosovës utilizimin maksimal të mundësive tregtare për vendin nga potenciali që ofron Porti i Shën Gjinit (porti i vetëm më i thellë se 30M në Detin Adriatik).
- (b) Rehabilitimi dhe renovimi i linjave që lidhin qytetet e Kosovës:
 - (i) Rehabilitimi dhe modernizimi i linjës hekurudhore: Prishtinë – Ferizaj;
 - (ii) Rehabilitimi dhe modernizimi i linjës hekurudhore: Prishtinë – Pejë;
 - (iii) Rehabilitimi dhe modernizimi i linjës hekurudhore: Pejë – Prizren.

c) **Dixhitalizimi**

Në vitin 2011, Kosova në Raportin e të Bërit Biznes të Bankës Botërore, është pozicionuar në vendin e 163-të. Pas investimeve të mëdha dhe të fokusuara në shërbimet kryesisht komunale-kryeqytet, tetë vite më pas, raporti i njëjtë e vë Kosovën në vendin e 13-të në vitin 2019, sepse u eliminuan procedurat e mëdha burokratike, të cilat përbënin problemin kryesor të kryerjes me efikasitet të shumë punëve të qytetarëve dhe të bizneseve. Dixhitalizimi ndikoi thelbësisht në sektorin bankar dhe atë të tregtisë. Sektori bankar ishte ai që pësoi rritje më të madhe të transformimit dixhital ku u përfshinë transaksionet elektronike nga interneti dhe nga celulari, kurse ai i tregtisë që dixhitalizimi të ndikojë në rritjen e transaksioneve elektronike, duke e rritur bindshëm blerjen online.

Në këtë kuptim, aktiviteti ekonomik do të rritet e do të fuqizohet përmes ngritjes së cilësisë së dixhitalizimit dhe shtrirjes së komunikimeve. Kosova ka nevojë që shërbimet e komunikimit t'i adresojë më mirë përmes politikave më të mira.

Transformimi dixhital në Kosovë është parakushti i domosdoshëm për zhvillim më të hovshëm dhe më të thellë ekonomik e social. Ky transformim mund të realizohet plotësisht vetëm nëse secilit qytetar, institucion dhe biznes u mundësohet cilësi e lartë e furnizimit me internet dhe nëse shërbimet e komunikimit vihen në dispozicion me çmime të volitshme për të gjithë njerëzit dhe bizneset pa marrë parasysh kush janë ata, ose ku jetojnë.

Për të arritur këtë nivel të qasjes për gjithë, duhet të sigurohen investime serioze dhe qasje e integruar për të siguruar përmirësimin e ndjeshëm të infrastrukturës së komunikimit, për të adresuar kërkesën në rritje për të dhëna si pasojë e nevojës për eksport të shërbimeve,

por edhe si pasojë e nevojës për qasje në rrjet të shpërndarjes së të dhënave. Rritja e konkurrencës dhe lehtësimi i shtrirjes së infrastrukturës së nevojshme do të inkurajojë dhe mundësojë investime të këtitilla.

Në të njëjtën kohë, duhet të bëhen përpjekje për të lejuar që të gjitha pjesët e shoqërisë të marrin pjesë në transformimin dixhital, përfshirë popullatën rurale që aktualisht kanë qasje më të dobët në internet/rrjet të shpërndarjes së të dhënave.

Meqenëse kërkesat për lidhje të besueshme dhe të shpejta në internet priten të rriten për arsye biznesi, por edhe individuale, qeveria jonë do të inkurajojë investime në infrastrukturë dhe shërbime komunikimi me cilësi të lartë dhe të përballueshme.

Përderisa më shumë njerëz dhe gjëra lidhen në rrjet, kërkesa do të vazhdojë të rritet në rrjete. Numri i pajisjeve të lidhura vetëm se do rritet, duke përfshirë ato që mundësohen nga teknologjitë në zhvillim si intelijenca artificiale (AI), që do të kërkojnë transmetimin e sasive të mëdha të të dhënave. Po ashtu, sektorët kritik siç janë shëndetësia ose energjia dhe sisteme tjera publike dhe private, do të varen nga besueshmëria e rrjeteve të komunikimit.

Për të siguruar qasje për të gjithë, me kosto të përballueshme për të gjithë, por edhe për të siguruar integritetin e sistemeve shtetërore dhe nevojave biznesore, qeveria jonë do të ndërmarrë këto masa dhe investime në avancimin e sistemit të telekomunikacionit, dixhitalizimit dhe shërbimeve të tilla:

- (i) Masa stimuluuese që orientojnë investimet private në ngritjen e shërbimit në gjitha zonat e Kosovës;
- (ii) Investim në digjitalizimin e gjitha shërbimeve shtetërore me theks të veçantë në administratë shtetërore dhe e-qeverisje;
- (iii) Ndërtimin e sistemeve të integruara digjitale shtetërore në arsim dhe shëndetësi;
- (iv) Investim në mjete dhe pajisje digjitale në gjithë sistemin arsimor e shëndetësor të Kosovës, duke përfshirë zëvendësimin e tërësishëm të infrastrukturës së mësimdhënies e mësimnxënies.

d) Infrastruktura rrugore

Zhvillimi i mëtutjeshëm i infrastrukturës rrugore përmes finalizimit të projekteve ekzistuese dhe projekteve të reja, do të kontribuojë në rritjen ekonomike dhe zhvillimin shoqëror e ekonomik, do të lehtësojë lidhjet tregtare dhe ekonomike me vendet fqinje dhe vendet anëtare të BE-së, si dhe midis qyteteve kryesore në Kosovë.

Kjo gjithashtu do të sjellë një përmirësim të dukshëm në sigurinë e komuniteteve përgjatë rrugëve ekzistuese, të cilët aktualisht janë të ndikuar nga shkëputja e ndjeshme si dhe rreziqet e trafikut.

Investime në këto projekte do të bëhen me procedura koncesionimi ose partneriteti publiko-privat, duke u siguruar që të përfundohet infrastruktura rrugore pa ndikime direkte buxhetore.

Përfundimi i infrastrukturës rrugore do t'i përfshijë këto akse rrugore:

- (i) Autostrada e Rrafshit të Dukagjinit;
- (ii) Ndërtimi i plotë i segmentit Morinë-Merdare;
- (iii) Ndërtimi, rehabilitimi dhe zgjerimi i të gjitha rrugëve që lidhin vendkalimet kufitare, duke përfshirë rrugët: Gjakovë - Qafë Prush, Podujevë - Merdare, Gjilan - Dheu i Bardhë dhe një degëzim rrugor që lidhë Gjilanin me Preshevën;
- (iv) Ndërtimi (viti i parë) i drejtimit Prishtinë-Pejë dhe lidhja me Malin e Zi.
- (v) Përfundim i autostradës së Gjilanit;
- (vi) Përfundimi me katër kors (dhe rehabilitimi) i të gjitha rrugëve të qendrave regjionale me Prishtinën.

Banka Kosovare për Investime dhe Zhvillim - BKIZH

Një institucion financiar i specializuar për zhvillim të qëndrueshëm e afatgjatë ekonomik të vendit, është domosdoshmëri për kohën tonë dhe për gjendjen e ekonomisë sonë.

Ne do ta themelojmë Bankën Kosovare për Investime dhe Zhvillim (BKIZh), e cila do ta ketë mision zhvillimin, ofrimin dhe promovimin e shërbimeve afatgjata financiare të dizajnuara për t'i plotësuar tregjet financiare në funksion të rritjes së konkurrueshmërisë së ekonomisë, krijimit të vendeve të reja të punës dhe zhvillimit të qëndrueshëm të Kosovës. Kjo bankë do të jetë e orientuar veçanërisht kah promovimi dhe sigurimi i eksporteve të produkteve finale, financimi i kompanive fillestare në fushën e teknologjisë së informacionit, eksporti i shërbimeve, zhvillimi i balancuar rajonal, kreditimi i investimeve strategjike dhe projekteve infrastrukturore.

Banka Zhvillimore është institucion i specializuar financiar, i cili ofron financim afatmesëm dhe afatgjatë për njësi të ndryshme të biznesit. Për dallim prej bankave komerciale, banka zhvillimore nuk pranon depozita prej publikut. As nuk është thjeshtë institucion që jep kredi të afatizuara. Banka Zhvillimore është institucion shumë qëllimor e multi funksional financiar. Banka zhvillimore është thelbësisht e orientuar kah zhvillimi. Qëllimi parësor i saj është të promovojë dhe ndihmojë zhvillimin ekonomik, duke promovuar investimet dhe veprimtaritë ndërmarrëse. Po ashtu inkurajon ndërmarrjet e vogla dhe të mesme dhe siguron zhvillim të balancuar rajonal.



Banka Zhvillimore ofron asistencë financiare për sektorin privat, por edhe për projekte të sektorit publik. Po ashtu ka për qëllim të promovojë shprehinë për të kursyer dhe investuar në ekonominë dhe kulturën tonë. Banka Zhvillimore nuk është në garë konkurruese me kanalet e zakonshme të financave, siç janë financimet nga bankat komerciale dhe institucionet tjera financiare. Roli kryesor i saj është që të mbushë zbrazëtirat financiare brenda ekonomisë sonë, dhe të plotësojë ato pjesë të ekonomisë të cilat nuk mbulohen nga burimet e zakonshme të financimit. Motivi i bankës zhvillimore është t'i shërbejë publikut. Rrjedhimisht punon në interesin e përgjithshëm të ekonomisë dhe shoqërisë sonë.

Bankat Zhvillimore janë pjesë përbërëse e sistemeve financiare në shumicën e vendeve perëndimore, por edhe të vendeve nëpër kontinentet tjera. Në rajonin tonë nga një bankë të tillë e kanë: Sllovenia – e themeluar në vitin 1992, Kroacia – e themeluar në vitin 1992, Bosnja dhe Hercegovina – e themeluar në vitin 1997, Maqedonia e Veriut – e themeluar në vitin 1998 dhe Bullgaria – e themeluar në vitin 1999.

Një institucion i tillë financiar i specializuar për zhvillim të qëndrueshëm, do të ishte i organizuar dhe menaxhuar në këtë mënyrë:

- i. Struktura e pronësisë
 - i. 51% në pronësi të Republikës së Kosovës;
 - ii. 25% në pronësi të një institucioni strategjik financiar;
 - iii. 24% të aksioneve do të jenë në dispozicion për shitje te personat privat (fizik dhe juridik), për të krijuar kështu një mekanizëm të volitshëm për thithjen e parave nga mërgata.
- j. Menaxhimi korporativ
 - i. Bordi mbikëqyrës – i përbërë nga 5 ministra të qeverisë (Min. i financave, Ekonomisë dhe Mjedisit, Bujqësisë, Infrastrukturës, Punës dhe Mirëqenies Sociale), 3 deputetë, kryetari i Odës Ekonomike.
 - ii. Bordi cakton orientimet strategjike të bankës dhe zgjedh Drejtorin Ekzekutiv;
 - iii. Drejtori Ekzekutiv është përgjegjës për operacionet e përditshmërisë së Bankës Zhvillimore;
 - iv. Kuvendi i Republikës së Kosovës përzgjedhë dhe emëron Komitetin e Auditimit të Operacioneve të Bankës;
 - v. Banka Zhvillimore mund të krijojë kompani subsidiare për t'i mbështetur operacionet e veta, siç është Kompania e Sigurimeve, e cila do ta bëjë sigurimin e investimeve të bankës, ose institucion mikrofinanciar që mbulon sektorë më të vogël se sa fushëveprimi i bankës.
- k. Sektorët investues:
 - i. Sektori prodhues, i orientuar kah eksporti i produkteve finale;
 - ii. Sektori i TI-së, i orientuar kah eksporti i shërbimeve;
 - iii. Projekte infrastrukturore që lehtësojnë aktivitetin ekonomik në sektorët e kredituar nga banka;

- iv. Mbështetje të zhvillimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme;
- v. Nxitje të mbrojtjes të mjedisit jetësor;
- vi. Prodhim i energjisë nga burime të ripërtëritshme;
- vii. Sigurim të eksportit të produkteve dhe shërbimeve prej rrezikut komercial dhe politik;
- viii. Sektorin minerar.
- l. Legjislacioni - Banka Zhvillimore, themelohet me ligj të veçantë.

Agjencia për Zhvillim Kombëtar

Një prej sfidave themelore me të cilat ballafaqohet secili projekt ristrukturues ekonomik, është inkompetenca strukturore, që nënkupton pamjaftueshmëri institucionale për ta zbatuar një projekt të tillë. Secila politikë ristrukturuese i kërkon institucionet e veta të veçanta. E veçanërisht një projekt i ristrukturimit ekonomik.

Për zbatimin e vizionit tonë ekonomik, përveç institucioneve të specializuara zhvillimore, na duhet edhe përbashkimi i kapaciteteve e kuadrove profesionale brenda një organi. Për këtë qëllim ne do ta themelojmë Agjencinë për Zhvillim Kombëtar (AZhK), organ ky që do të jetë brenda Zyres së Kryeministrit të Kosovës dhe do t'i përgjigjet drejtpërdrejtë atij.

Përgjegjësia themelore e AZhK-së (Agjencia për Zhvillim Kombëtar), është koordinimi i politikave shtetërore, ndërministrore, me kapacitetet financiare të institucioneve vendore, por veçanërisht me fondet ndërkombëtare, për t'i kanalizuar ato drejtë sektorëve strategjik të identifikuar për zhvillim në Republikën e Kosovës.

Struktura, përgjegjësitë dhe funksioni i AZhK-së (Agjencia për Zhvillim Kombëtar), do të caktohen me ligj të veçantë.

Me AZhK-në, projekti zhvillimor ekonomik, promovimi dhe mbështetja e investimeve, identifikimi dhe mbështetja e sektorëve strategjik, krijimi i vendeve të reja të punës, rritja e cilësisë dhe produktivitetit të punës, përmirësimi i bilancit tregtar përmes rritjes së investimeve, integrimi përfitues në zhvillimet rajonale e evropiane, do të bëhet prioritet kryesor i Qeverisë.

Roli i AZhK-së është si më poshtë:

m. Përpilimi i strategjisë së zhvillimit të qëndrueshëm dhe afatgjatë të Kosovës

Kjo strategji është e rëndësishme për t'i bërë bashkë masat afatshkurta me ato afatmesme dhe afatgjata, drejt një zhvillimi të hovshëm dhe të qëndrueshëm. Për më tepër strategjia:

- i. Identifikon sektorët strategjik zhvillimor të Kosovës;
- ii. Identifikon përparësitë kryesore krahasuese të Kosovës në tregjet rajonale, evropiane dhe globale;
- iii. Identifikon burimet financiare dhe kanalizon ato drejtë sektorëve strategjik.
- iv. Identifikon kualifikimet e nevojshme të fuqisë punëtore për konkurrueshmërinë e bizneseve të Kosovës;
- v. Vendosë standardet e cilësisë së produkteve dhe shërbimeve kosovare dhe e përcakton strategjinë e përmirësimit dhe mirëmbajtjes së brendit “Made in Kosova”.

n. Projekte për fondet me destinim rajonin (BE, DSC, Berzh, etj.)

AZhK do të jetë e përqendruar në sigurimin e financimit nga jashtë për projektet strategjike e zhvillimore të Kosovës.

- i. Përpilimi i projekteve për aplikim në fondet e institucioneve ndërkombëtare financiare të destinuar për rajonin;
- ii. Koordinimi i donatorëve, granteve dhe kredive për ta rritur efektshmërinë dhe kapacitetin absorbues të ekonomisë sonë;
- iii. Rritja e kapaciteteve absorbuese e projektuese për fondet e destinuar në kuadër të 'Procesit të Berlinit';
- iv. Prezantimi dhe negociimi i projekteve të reja që nuk gjenden në planifikimet afatgjata të këtyre institucioneve financiare, por që kanë një interes të madh zhvillimor për Kosovën.

- o. Identifikim i projekteve strategjike që financohen nga mekanizmi publik investiv

AZhK bashkërendohet ngusht me Bankën Kosovare për Investime dhe Zhvillim, për të financuar projekte zhvillimore të cilat nuk janë në listën e projekteve të financuara nga institucionet ndërkombëtare financiare.

- p. Shkrirja e mandatit për promovim dhe mbështetje të investimeve dhe eksportit

Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA), do të shkrihet brenda AZhK-së për ta rritur kështu sinergjinë bashkërenduese në promovim dhe mbështetje të investimeve, eksportit, turizmit, NVM-ve, dhe Zonave të Veçanta Ekonomike në Republikën e Kosovës.

- q. Bashkërendimi i politikave mes ministrive dhe agjencive tjera

AZhK do ta ketë përgjegjësi ekskluzive bashkërendimin e punës së ministrive përkatëse, për t'i orientuar politikat sektoriale drejtë vizionit zhvillimor të Kosovës. AZhK është institucioni kryesor bashkërendues i kryeministrit për secilin vendim që ndërlihet me ekonominë.

- r. Koordinimi i kërkesës ekonomike për kuadro me sistemin arsimor
AZhK do të ketë bashkërendim të ngushtë me Ministrinë e Arsimit dhe me institucionet arsimore të Kosovës, për t'i orientuar kapacitetet kadrovike drejtë projektit shtetëror zhvillimor.

Bursa Kombëtare

Sistemi financiar i bazuar në banka, është bërë metoda dhe mënyra kryesore për financimin e investimeve në Kosovë, por edhe në Shqipëri. Shumica e firmave varen ndjeshëm nga bankat për likuiditet afatshkurtër dhe kapital afatgjatë. Ky lloj i sistemit financiar siguron vetëm shërbime bazike bankare, pra kursime dhe kredi, përderisa nevojat ekonomike e financiare të ndërmarrjeve në Kosovë, por edhe në Shqipëri janë tashmë të avancuara dhe kanë nevojë për instrumente e mundësi shtesë për financim.

Ndërlidhja e planeve zhvillimore të dy shteteve, me krijimin e kushteve dhe institucioneve për të përmbushur nevojat për financim të sektorit privat, janë elemente sistemore pa të cilat nuk mund të ketë kapërcime zhvillimore.

Në këtë kontekst qeveria e udhëhequr nga Aleanca e ka paraqitur Bankën Zhvillimore për Investime në Kosovë, por përtej kësaj Aleanca propozon që masave dhe projekteve të liberalizimit financiar, të cilat u zbatuan në të gjithë rajonin në mënyrë që të promovojnë konkurrencën e sektorëve bankarë kombëtar dhe efikasitetin dhe produktivitetin e përgjithshëm bankar, t'iu bashkëngjitet edhe tregu i kapitalit.

Është evidente që dy qeveritë, ajo e Kosovës dhe Shqipërisë kanë filluar ndërveprim të theksuar ekonomik, që nga infrastruktura e deri te projektet tjera strategjike. Por, këtyre duhet t'iu bashkëngjitet edhe iniciativa për themelimin e Tregut Rajonal të Kapitalit, pra Bursa Rajonale Shqiptare, e cila do ishte hapi i parë në ndërtimin e një burse më të gjerë rajonale, që do të mund të përfshinte edhe vende tjera si Mali i Zi e Maqedonia e Veriut.

Zhvillimi i një tregu të kapitalit është i mundshëm dhe mund të luaj një rol të rëndësishëm në zhvillimin e një ekonomie, posaçërisht nëse ky treg i kapitalit është rajonal Kosovë-Shqipëri. Kjo bursë do të ofronte kontribut e mundësi ekonomike të cilat nuk mund të nënvlerësohen, duke luajtur një rol të rëndësishëm në promovimin e cilësisë së sistemeve financiare, dmth., inkurajimi i blerjes së informacionit, transparenca dhe monitorimi i korporatave, menaxhimi i rrezikut financiar, diversifikimi i investimeve dhe mobilizimi i kursimeve.

Të dyja vendet përgjatë dekadës së fundit kanë shpërfaqur potencial të mirë ekonomik, dhe këtij potenciali duhet bashkëngjitur edhe bursën në mënyrë që të përshpejtohet qasja në kapital dhe të sigurohet zhvillim afatgjatë.

Investimet në krijimin e bursës shqiptare detyrimisht do të bëjnë mjediset e investimeve të vendeve tona më efikase, konkurruese dhe të krahasueshme me vendet më të zhvilluara.

Një bursë rajonale ka mundësi të mobilizojë burime të reja të financave afatgjata, duke zvogëluar rëndësinë të sistemeve tradicionale e shpesh kundër produktive bankare.

Për më tepër, financimi i kapitalit për shkak të tregut të aksioneve mund të bëhet një burim i rëndësishëm i investimeve nga jashtë (investitor të huaj dhe diaspora) në vendet tona. Në situatën e tanishme bizneset e kanë të vështirë të marrin financim afatgjatë nga bankat që janë nën presion të fortë për të përmirësuar bilancet e tyre dhe plotësojnë standardet e mjaftueshmërisë së kapitalit dhe qëndrueshmërisë sipas kërkesave të Bankës Qendrore.

Financimi i borxhit është gjithashtu i rëndësishëm. Për shembull, tregjet e obligacioneve të korporatave mund të shfaqen si rezultat i tregjeve më të mëdha të obligacioneve qeveritare.

Sidoqoftë, përparësitë kryesore të zhvillimit të tregjeve rajonale të kapitalit në vendet më pak të zhvilluara si Kosova dhe Shqipëria, vijnë nga konkurrenca midis bursës dhe industrisë bankare. Bursa ushtron presion mbi bankat për të ri dizajnuar normën e tyre të interesit dhe maturitetet me norma efikase, e kështu përfitojnë edhe ata që kursejnë në banka, por edhe shfrytëzuesit e fondeve. Rrjedhimisht, Bursa Shqiptare do t'u sigurojë investitorëve privat, juridik dhe shtetëror mundësi më të mëdha për zhvillim, rritje e përbashkim ekonomik.

Masat e propozuara për të ndërtuar Bursën Shqiptare janë këto:

- a. Ndërtimi dhe përshtatja e infrastrukturës ligjore të të dyja vendeve për të krijuar institucionin e tregut të kapitalit, Bursën Shqiptare;
- b. Identifikimi, përgatitja, trajnimi dhe informimi i kompanive publike dhe private për të tregtuar aksionet e tyre në bursë;
- c. Definimi i kërkesave minimale që duhen plotësuar për listimin e kompanive në bursën rajonale;
- d. Definimi i planit kohor dhe mënyrës së integritimit të produkteve financiare të tregtueshme në bursë.





SIGURIA DHE SUNDIMI I LIGJIT

Siguria

Jemi vendosur në rresht me shtetet demokratike për liri dhe paqe. Kemi arritur ta bëjmë Kosovën me ushtri. Tani Kosova do të bëhet partner serioz për rajonin dhe botën demokratike.

Përmbushja e detyrimeve kushtetuese në fushën e mbrojtjes, përballimin e emergjencave civile dhe fatkeqësive natyrore, mbështetja e vazhdueshme ndaj institucioneve dhe qytetarëve, zgjerimi i hartës gjeografike të pjesëmarrjes në misionet ndërkombëtare të Ushtrisë së Kosovës, si dhe iniciimi e zbatimi i kontratave në fushën e modernizimit në infrastrukturë dhe pajisje ushtarake janë prioritet i Aleancës.

Tash, do ta plotësojmë infrastrukturën sigurisë shtetërore dhe do ta bëjmë Kosovën shtet model për rajonin. Aleanca do të sigurojë zhvillimin dhe implementimin e masave si në vijim:

- ✓ Ushtria
- ✓ Modernizim i vazhdueshëm i ushtrisë me pajisje dhe armatim ushtarak;
- ✓ Edukim i avancuar për ushtarët e Kosovës;
- ✓ Program të veçantë lobues dhe avokues për hyrje në Partneritet për Paqe;
- ✓ Pjesëmarrje në misionet paqeruajtëse ndërkombëtare;
- ✓ Zbatim i suksesshëm i tranzicionit në kohë dhe përmbajtje;
- ✓ Zhvillim i konceptit të Mbrojtjes Strategjike;
- ✓ Ndërveprim i plotë më SHBA-të dhe NATO-n;
- ✓ Fuqizim të kapaciteteve të inteligjencës së mbrojtjes;
- ✓ Rritje e buxhetit për mbrojtje deri në 2% të BPV-së;
- ✓ Krijimi i konceptit dhe praktikës së Mbrojtjes Civile.

Policia

- ✓ Zhvillim dhe profesionalizim i policisë;
 - ✓ Modernizim i pajisjeve të policisë;
 - ✓ Rritje e kapaciteteve të specializuara të policisë;
 - ✓ Fuqizim i kapaciteteve të menaxhimit dhe kontrollit të kufirit, rendit dhe sigurisë publike;
 - ✓ Avancim i kapaciteteve të inteligjencës policore;
 - ✓ Sigurim shëndetësor për policinë.
- Ballafaqimi me rreziqet e jashtme
- ✓ Forcimi i vazhdueshëm i Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë në partneritet me aleatët;
 - ✓ Forcimi i kapaciteteve për ballafaqimin me influencat e jashtme armiqësore;
 - ✓ Fuqizim i kapaciteteve për Siguri Kibernetike - mjedis të sigurt të hapësirës kibernetike;
 - ✓ Mobilizim i institucioneve të sigurisë dhe zbatimit të ligjit për përballje me kërcënimet hibride.

Partneritet për Siguri

- ✓ Thellim i partneritetit strategjik me SHBA-të;
- ✓ Thellim i partneriteteve bilaterale me shtetet demokratike dhe të rajonit;
- ✓ Avancim drejt anëtarësimit në NATO;
- ✓ Qasje e përbashkët rajonale në angazhime të sigurisë.

Shteti i së Drejtës

Sundimi i ligjit është vënë si prioritet kryesor i qeverisjes. Angazhimi për të ndërtuar një qeverisje demokratike, gjithëpërfshirëse dhe efektive që do t'i shërbejë popullit të Kosovës pa diskriminim, fillon me një sundim të fortë të ligjit. Në adresimin e sundimit të ligjit si çështje komplekse, ne kemi identifikuar një qasje më të koordinuar, veçanërisht duke zbatuar implementimin e disa niveleve të politikave:

- I. Llogaridhënia në sundimi i ligjit;
- II. Kthimi i dinjitetit dhe pavarësimi i institucioneve të sundimit të ligjit;
- III. Përgjegjësia institucionale efektive;
- IV. Drejtësi e pavarur;
- V. Luftimi i korrupsionit dhe krimit të organizuar;
- VI. Intervenimet e drejtpërdrejta në politikat publike të sundimit të ligjit dhe drejtësisë.

I. LLOGARIDHËNIA NË SUNDIMIN E LIGJIT

Për të adresuar çështjen e llogaridhënies brenda mandatit kushtetues dhe ligjor, do të bëhet një Grup Koordinues në nivel të Presidentit të Republikës së Kosovës si iniciativë që mbledhë të gjitha institucionet e Kosovës, të angazhuara në fushën e sundimit të ligjit me qëllim që të analizojnë “gjendjen aktuale” dhe të vendosin një qasje strategjike në mënyrë të koordinuar. Ky forum është përcaktuar si një takim operacional në identifikim-
✓ e rezultateve konkrete dhe përcjelljen e të gjithë institucioneve të sundimit të ligjit dhe
✓ zbatimit të ligjit. Takimet do të jenë të rregullta dhe adresojnë objektivat e mëposhtëm:

- ✓ Koordinimi i aktiviteteve dhe llogaridhënia në sundimin e ligjit;
- ✓ Identifikimi dhe koordinimi i aktiviteteve në mbështetje të zbatimit të legjislationit dhe politikave në sundimin e ligjit;
- ✓ Përcaktimi i përparësive dhe politikave për zbatimin e agjendës legjislative për të rritur efektivitetin e institucioneve të sundimit të ligjit;
- ✓ Koordinimi i punës dhe aktiviteteve të institucionit përgjegjës për forcimin e mekanizmit ekzistues për sundimin e ligjit;
- ✓ Rritja e ndërgjegjësimit social për rëndësinë e sundimit të ligjit.

II. KTHIMI I DINJITETIT DHE PAVARËSIMI I INSTITUCIONEVE TË SUNDIMIT TË LIGJIT

Kjo qeveri do të fokusohet në kthimin e dinjitetit dhe pavarësisë së policëve, prokurorëve dhe gjyqtarëve. Është e rëndësishme që të ofrohen kushte të dinjitetshme të punës, në mënyrë që të shmangen rrugët e mundshme të korrupsionit. Një polic, prokuror ose gjyqtar me pagë dhe kushte të dinjitetshme punon më shumë, është më i pavarur dhe shteti mund të kërkojë më shumë llogaridhënie. Disa nga politikat që do të ndërmerren janë si në vijim:

- ✓ Buxheti për institucionet e drejtësisë do të rritet për 35%;
- ✓ Pagat e gjykatësve dhe prokurorëve pas rritjes nga Qeveria Haradinaj prej 100% të pagës, do të komplementohen me shtesat e rrezikshmërisë në punë, jashtë orarit dhe me gradime;
- ✓ Në implementim të ligjit të pagave, policisë përveç se do t'ju paguhen të gjitha orët shtesë, do të kenë status të veçantë dhe rroga më e ulët e policit do të jetë rreth 700 Euro, varësisht nga grada që ka;
- ✓ Do të shtyhen përpara ligji për pensionim dhe ligji për sigurim të policisë;
- ✓ Rritja e numrit të prokurorëve dhe gjyqtarëve në Departamentin për Krimet e Luftës;
- ✓ Gjyqtarët special do të paguhen sa prokurorët special me shtesën mujore prej 400 Euro.

III. PËRGJEGJËSIA INSTITUCIONALE EFEKTIVE

Kosova është përballur me sfida në efektivitetin institucional duke iu përgjigjur sfidave të sundimit të ligjit. Për ta rritur përgjegjësinë institucionale, janë identifikuar dy (2) kurse veprimi:

1. Regjistri i rasteve të shënjestruara;
2. Menaxhimi dhe Siguria e Migracionit.

Regjistri i rasteve të shënjestruara kundër korrupsionit e krimit të organizuar do të rritet - Qasja në regjistrin e rasteve duhet të jetë e kujdesshme, duke shmangur ndërhyrjen dhe duke theksuar efektivitetin. Të gjitha rastet e shënjestruara që kanë vepra penale të korrupsionit përpunohen, duke i rritur ato gjithashtu.

Menaxhimi dhe Siguria e Migracionit - Do të arrihet një progres i konsiderueshëm në administrimin e migracionit të parregullt përmes rritjes së kapaciteteve në institucionet përkatëse dhe pakos së ligjeve, përkatësisht Ligjit për Azilin, Ligjit për të Huajt dhe ndryshimet në Ligjin për Kufirin Shtetëror dhe Mbikëqyrjen.

Procesi i riadhesimit të kosovarëve që kthehen nga vendet e BE-së do të ndiqet me sukses dhe i koordinuar nga afër si kusht për liberalizim të vizave.

IV. DREJTËSI E PAVARUR DHE EFIKASE

Në fushën e rendit dhe ligjit, qeveria do të angazhohet që përmes funksionimit të shtetit ligjor e efikas, të rris besueshmërinë e qytetarëve në institucionet e vendit dhe përkrahjen për institucionet. Rritja e besueshmërisë në institucione nënkupton rritje të efikasitetit të punës së institucioneve dhe zgjidhje të drejtë të çështjeve të parashtruara. Një sistem i tillë i drejtësigë siguron kohezionin e brendshëm socio-ekonomik në tërë Republikën e Kosovës.

Avancimi dhe forcimi i institucioneve të drejtësigë - Si parim, do të promovohet shteti ligjor llogaridhënës dhe transparent, duke rritur transparencën përmes hapjes ndaj publikut dhe gjithë-përfshirjes në mbikëqyrje, përmes forcimit të mekanizmave llogaridhënës, përmes zbatimit të llogaridhënies institucionale të pavarur dhe jopolitike, gjithmonë duke vlerësuar punën për t'u siguruar që llogaridhënia nuk kthehet në mekanizëm për ndikim.

Mes masave që do të ndërmarrim do të jenë edhe rishikimi i legjislacionit që rregullon sistemin e drejtësigë që lidhet me funksionimin më efikas të institucioneve të drejtësigë, për të siguruar edhe qasjen e lirë dhe të barabartë për qytetarët në drejtësi.

Llogaridhënia dhe efikasiteti i sistemit të drejtësigë - Do të avancohet baza ligjore, në përputhje me standardet evropiane, për rekrutimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, bazuar ekskluzivisht mbi bazën e meritave. Do të krijohet baza ligjore për një sistem të fortë dhe transparent të matjes së performancës në institucionet e drejtësigë, e cila do të jetë baza themelore mbi të cilën gjyqtarët dhe prokurorët do të avancohen. Do të krijohen resurset e nevojshme për trajnime të vazhdueshme dhe të detyrueshme për gjyqtarët dhe prokurorët, me qëllim të profilizimit dhe ngritjes së kapaciteteve të tyre. Do të rritet numri i bashkëpunëtorëve profesional në institucionet e drejtësigë për punë më efikase të këtyre institucioneve.

Vetingu - Implementimi i planit të vetingut i përpiluar nga Ministria e Drejtësigë, ku të gjithë personat që nuk meritojnë të ndjekin dhe ndajnë drejtësi do të largohen nga sistemi dhe do të mbrohen të ndershmit. Ky plan do të formojë një mekanizëm të përherëshëm të vetingut.

V. LUFTIMI I KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR

Luftimi i pakompromis i korrupsionit, krimeve, terrorizmit dhe aktiviteteve të lidhura me dukurinë e terrorizmit, krimit ekonomik, trafikimit të qenieve njerëzore dhe llojeve të tjera të kriminalitetit do të jetë angazhim i përhershëm i qeverisë.

- ✓ Në këtë drejtim, do të promovohet profesionalizmi i institucioneve përgjegjëse, duke siguruar mbështetje më të madhe buxhetore;
- ✓ Implementimi i ligjit të Agjencisë për Parandalim të Korrupsionit. Do të bëhet suspendimi i zyrtarëve që kanë aktakuza për korrupsion, në fokus të veçantë do të jenë ata për keqpërdorim të tenderëve;
- ✓ Ndryshimi dhe implementimi i Kodit të Procedurës Penale, ku të gjithë zyrtarët publik që kapen në korrupsion do të shkarkohen qysh në fazën e aktakuzës;
- ✓ Themelimi i Task Forcës Kundër Korrupsionit, e cila do të shndërrohet në institucion permanent si Byro e Hetimeve – një kombinim i hetimit, policisë gjyqësore dhe ndjekjes.

VI. INTERVENIMET E DREJTPËRDREJTA NË POLITIKAT PUBLIKE E TË SUNDIMIT TË LIGJIT DHE DREJTËSISË

Reforma e thellë në drejtësi - Implementimi i planit të rishikimit funksional që garanton më shumë pavarësi të gjyqësorit dhe prokurorisë. Do të eliminohet nepotizmi dhe do të forcohet meritokracia. Politika duart larg drejtësisë.

Dhomat e Specializuara - Shteti do të garantojë mbrojtje dinjitoze për të akuzuarit potencial dhe do të asistojë familjet e tyre gjatë tërë procesit. Vlerat dhe pastërtia e luftës çlirimtare të Kosovës do të mbrohen me çdo kusht.

Gjykata Komerciale -Implementimi i gjykatës komerciale do të jetë një adresë për bizneset dhe që do t'i ndalojë keqpërdorimet nëpër gjykata në dëm të bizneseve.

Instituti për Hulumtimin e Krimeve të Luftës - Implementimin e konceptit për krijimin e institutit ku do të bëhet dokumentimi dhe ruajtja e gjithë materialit për krimet e luftës në Kosovë. Punësimi i 100 studentëve hulumtues në terren.

Me qëllim të zhvillimit, realizimit dhe sigurimit të sundimit të ligjit, si Aleancë do t'i ndër-marrim hapat e përshpejtuar për iniciimin dhe përmbylljen e veprimeve si në vijim:

- Grup Koordinues në nivel të Presidentit të Republikës si iniciativë që mbledhë të gjitha institucionet e Kosovës, të angazhuara në fushën e sundimit të ligjit;
- Buxheti për institucionet e drejtësisë do të rritet për 35%;
- Pagat e gjykatësve dhe prokurorëve pas rritjes nga qeveria Haradinaj prej 100% do të komplementohen me shtesat e rrezikshmërisë në punë, jashtë orarit dhe me gradime;
- Në implementim të Ligjit të Pagave, policisë përveç se do t'ju paguhen të gjitha orët shtesë, do të kenë status të veçantë dhe rroga më e ulët e policit do të jetë rreth 700 Euro, varësisht nga grada që ka;
- Do të shtyhen ligji për pensionim dhe Ligji për sigurim të Policisë;
- Rritja e numrit të prokurorëve dhe gjyqtarëve ne Departamentin për Krimet e Luftës;
- Gjyqtarët specialë do të paguhen sa prokurorët specialë me shtesën mujore prej 400 Euro;
- Regjistri i rasteve të shënjestruara kundër korrupsionit e krimit të organizuar do të përditësohet;
- Implementimi i planit të vetingut që i mbron të ndershmit e i largon të korrup-tuarit;
- Implementimi i ligjit të Agjencisë për Parandalim të Korrupsionit;
- Themelimi i Task Forcës Kundër Korrupsionit, e cila do të shndërrohet në in-stitucion permanent si Byro e Hetimeve – një kombinim i hetimit, policisë gjyqësore dhe ndjekjes;
- Strategjia 5 vjeçare për reformën e thellë në drejtësi;
- Mbrojtje dinjitoze e çlirimtarëve dhe familjeve të tyre në Dhomat e Special-izuara;
- Implementimi dhe operacionalizimi i Gjykatës Komerciale;
- Ndryshimi dhe implementimi i Kodit të Procedurës Penale që ndjek kriminelët e luftës;
- Themelimi i Institutit për Hulumtimin e Krimeve të Luftës – që punëson 100 studentë hulumtues.



Aleanca punon që secilit qytetar t'i ofrohet mundësia e arsimimit dhe aftësimin cilësor.

Mirëqenia

Kosova i ka të gjitha mundësitë për zhvillim. Qytetarët e Kosovës mund të jetojnë të sigurt dhe në begati. Aleanca angazhohet për arritjen e aspiratave individuale dhe kolektive të njerëzve të Kosovës. Të gjithë ne bashkë, të rinj e të moshuar, gra e burra, e kemi në dorë të ardhmen tonë! Shteti i pavarur dhe sovran është mundësia jonë për prosperitet dhe mirëqenie!

E drejta për avancim individual, përmirësim të shkathtësive për punë dhe rritje të të mirave do të jetë prioritet yni. Kosova është një ndër vendet më të pasura me resurse natyrore në rajon e Evropë, një mundësi e jashtëzakonshme për zhvillimin ekonomik dhe ngritje të mirëqenies.

Arsimi

Aleanca punon që secilit qytetar t'i ofrohet mundësia e arsimit dhe aftësimin cilësor, i orientuar kah kërkesat e tregut të punës që ka për qëllim rritjen e punësimeve dhe zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik.

Qëllimi është që t'u ofrojë të gjithë qytetarëve të Kosovës mundësitë e të mësuarit që përshtaten me nevojat dhe aftësitë e tyre në të gjitha fazat e jetës në forma dhe vende të ndryshme, të cilat mund të stimulohen dhe të mbështeten, në mënyrë që ata të maksimizojnë mundësitë për vetëvlerësim dinjitoz brenda shoqërisë, në punën e tyre si dhe në jetën e tyre familjare.

Fokusimi në të mësuarit dixhital gjatë gjithë jetës për të aplikuar teknologjinë moderne digjitale në mësimdhënie dhe mësimnxënie, në mënyrë më efektive dhe me rezultate më të mira, për të përmirësuar shkathtësitë dixhitale dhe për të garantuar qasjen në gjeneratën më të re të infrastrukturës dixhitale.

Do të punojmë në krijimin e mundësive për qasje dhe mundësi të barabarta dhe shërbime cilësore arsimore për të gjithë qytetarët e Kosovës.

Si rezultat i pandemisë COVID-19 dhe përgatitjeve për të ardhmen do të punohet në organizimin e mësimin në objekte shkollore dhe në minimizimin e rrezikut për shëndetin e fëmijëve, stafit të institucioneve arsimore, familjeve të tyre dhe shoqërisë si dhe në ngritjen e cilësisë në sistemin arsimor.

Do të vazhdohet në zbatimin e masave dhe skenarëve të miratuar për organizimin e mësimin në kushte pandemie dhe në kompensimin e pjesës së humbur sipas planit mësimor. Do të bëhet vlerësimi i realizimit të planit mësimor në përdhën e parë dhe do të punohet për të përmbyllur me sukses vitin shkollor si dhe realizimin e objektivave të parapara me planin mësimor. Do të punohet për të përgatitjen dhe mbajtjen e testit të arritshmërisë, testit të maturës dhe provimeve në të gjitha institucionet arsimore.

Infrastruktura arsimore

edukatës fizike, laboratorë, punëtori, biblioteka shkollore dhe infrastrukturë tjetër përcjellëse. Do të investohet në modernizimin e infrastrukturës në arsimin e lartë.

Do të përmirësohet infrastruktura arsimore në funksion të ngritjes së cilësisë dhe do të bëhet furnizimi me inventar, pajisje të TI, pajisje laboratorike, pajisje të pakove sportive dhe pajisje për mirëmbajtje dhe fusha lëndore. Do të investohet në ngritjen dhe modernizimin e kampuseve dhe infrastrukturës përcjellëse e hulumtuese në arsimin e lartë.

Kurrikula dhe tekstet mësimore

Do të bëhet vlerësimi dhe përmirësimi i kurrikulave mësimore në funksion të ngritjes së cilësisë, do të rishikohen politikat për hartimin e materialeve mësimore dhe udhëzuesve për zbatimin e kurrikulave;

Do të punohet në themelimin e Qendrës së Vlerësimeve dhe Standardeve si institucion i pavarur, për përgatitjen dhe organizimin e testeve të jashtme kombëtare dhe ndërkom-bëtare e për vlerësimin e performancës;

Tekstet shkollore do të rishikohen në faza të paracaktuara kohore dhe nxënësit do të kenë tekste të reja shkollore për vitin shkollor 2021/22 dhe për pjesën tjetër të teksteve në peri-udhën 2022/23.

Arsimi parauniversitar

Për të qartësuar detyrat dhe përgjegjësitë e institucioneve dhe organeve mbikëqyrëse institucionale të arsimit, është e nevojshme që të bëhet një rishikim i plotë i strukturës qeverisëse të arsimit, ndërsa për arsimin parauniversitar është çështje që duhet trajtuar. Në procesin mësimor do të zbatohen platforma, teknologji dixhitale, pajisje dhe mjete tjera mësimore, për të ngritur cilësinë e mësimdhënies dhe të nxënësve si dhe për të zhvilluar kompetencat dixhitale. Do të bëhet furnizimi i institucioneve arsimore me pajisje hard-vereke, softvereke e rrjete kompjuterike për krijimin dhe shfrytëzimin e shërbimeve online dhe përmbajtjeve dixhitale për nevojat e sistemit të arsimit.

Edukimi parashkollor

Do të punohet në zgjerimin e infrastrukturës për arsimin parafillor dhe pajisja e IEAP-ve me mjete didaktike dhe në trajnimin e stafit që punojnë në edukim parashkollor dhe para-fillor. Do të punohet në rritjen e përfshirjes së fëmijëve në edukimin parashkollor.

Do të hartohen standardet e edukimit parashkollor të cilësisë së lartë duke përfunduar arsimin, shkencën dhe ekonominë. Do të bëhet përgatitja e materialeve didaktike dhe materialeve për realizimin e mësimin për edukim parashkollor. Edukimi në fëmijërinë e hershme do të jetë në fokus edhe gjatë kësaj periudhe kohore. Platforma online “Edukimi në distancë - Kujdesi, Zhvillimi dhe Edukimi në fëmijërinë e hershme për moshën 0-6 vjeç, vazhdimisht do të plotësohet me materiale të përkthyer në gjuhët serbe, turke dhe rome dhe do të transmetohen në televizionin publik.

Do të sigurohen mundësi për qasje në arsim duke respektuar të drejtat e njeriut për të gjitha grupet e nxënësve dhe studentëve; nxënësit dhe studentët me nevoja të veçanta, grupet e marginalizuara, komunitetet jo shumicë, vajzat dhe gratë, grupet me gjendje të vështirë ekonomike e sociale dhe të tjerët. Për këtë qëllim do të hartohen udhëzues për integrimin e qasjes së bazuar në të drejtat e njeriut në shkollimin e rregullt në të gjitha nivelet e arsimit në Kosovë.

Do të vazhdohet me popullimin e platformës “Arsimi Gjithëpërfshirës” me aktivitete mësimore dhe materiale didaktike e në zbatimin e pakos me dokumentet për vlerësimin pedagogjik të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore.

Do të krijojmë kushte për arsim cilësor për të gjitha komunitetet, në të gjitha nivelet në gjuhën e tyre amtare dhe në ofrimin e mbështetjes financiare me bursa për fëmijët e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian.

Arsimi dhe aftësimi profesional

Në fushën e AAP-së do të sigurohet një ndërlidhje më e fuqishme e kurrikulave të AAP-së me fushat deficitare kombëtare dhe tregun e punës.

Do të finalizohet procesi i rishikimit të kurrikulave bërthamë për arsimin dhe aftësimin profesional.

Do të vazhdohet me zhvillimin dhe aprovimin e 20 standardeve të profesionit dhe kualifikimeve përkatëse, përfshirë edhe në përgatitjen e materialeve mësimore dhe furnizimin me pajisje më së paku të 10 shkollave.

Do të organizohet hulumtimi për rrjetin e shkollave nëpër të gjitha regjionet e Kosovës, ndërsa për t'i paraparirë rrjetëzimit të IAPP-së, do të analizohen të gjitha profilet dhe kërkesat për profile të reja sipas sektorëve prioritar dhe me potencial për zhvillim ekonomik të vendit. Rezultatet e punës së grupeve teknike dhe të grupit bërthamë për qeverisje në sistemin e AAP-së, do të na ndihmojnë në ndërtimin e një koncepti të qartë për optimizimin e strukturës qeverisëse, mbi përgjegjësitë dhe detyrat e Agjencisë së AAPARr, Këshillit të AAPARr dhe institucioneve tjera, përfshirë edhe ndërhyrjet e nevojshme në politikat dhe kornizën ligjore të sektorit të AAP-së.

Do të punohet në shfrytëzimin e Barometrit të Tregut të Punës për të mundësuar komunikimin strategjik dhe ndërveprimin e bazave të të dhënave të 10 institucioneve, i cili do të kontribuojë për të mbështetur: hartimin e politikave të bazuara në të dhëna për planifikimin dhe zhvillimin strategjik, digjhtalizimin, axhendën e aftësive të BE-së dhe zbatimin e ERP-së.

Do të punohet në finalizimin dhe aprovimin e modelit të financimit të arsimit dhe aftësimin profesional dhe formulës së financimit për profile përkatëse për të përmirësuar cilësinë e ofertës së AAP-së dhe plotësimin e hendekut të shkathtësive ndërmjet ofertës dhe kërkesës.

Përmirësimi i trajnimit të mësimdhënësve (Zbatimi i Kornizës për Zhvillim Profesional të Mësimdhënësve) dhe Zbatimi i Strategjisë për Sigurim të Cilësisë.

Do të punohet në sigurimin e institucionalizimit të qëndrueshëm të trajnimeve të zhvillimit profesional për mësimdhënësit brenda dhe para shërbimit si dhe menaxhimi i arsimit me marrëveshje ndërmjet ministrisë dhe fakultetit të edukimit, për institucionalizimin dhe qëndrueshmërinë e programeve të trajnimit, të zhvilluara nga partnerët dhe donatorët. Do të punohet që të sigurohet korniza ligjore për pensionim e parakohshëm të mësimdhënësve me probleme shëndetësore si dhe në trajnimin dhe riaftësimin e mësimdhënësve që të japin mësim në fusha të përafërta, nëse mbesin tepricë për shkak të optimizimit të rrjetit të shkollave, rënies së numrit të nxënësve ose optimizimit të profileve arsimore.

Arsimi i Lartë

Do të finalizohet rishikimi i ligjit për arsimin e lartë për të siguruar se janë përmbushur kërkesat për avancimin e autonomisë së këtyre institucioneve, financimin e qëndrueshëm, ndërlidhje dhe harmonizim më të mirë me kërkesat e tregut të punës dhe integrim më të mirë në sistemin Evropian të arsimit të lartë.

Do të punohet në sigurimin e pavarësisë së plotë financiare të universiteteve publike, harmonizimin e rregulloreve të këtyre universiteteve, në proflizimin e universiteteve publike dhe promovimin e programeve dhe fakulteteve të shkencave të aplikuara. Do të operacionalizohet sistemi SMIAL, përfundohet rishikimi i formulës së financimit, vazhdohet me akreditimin dhe ri akreditimin e programeve të studimeve dhe do të bëhet monitorimi i kuotave të regjistrimit të studentëve, sipas vendimeve të akreditimit në programe përkatëse, kërkesave të tregut të punës dhe resurseve në dispozicion.

Do të finalizohet procesi i ndarjes së UPHP-së në tri universitete: UP, Universiteti i Shkencave të Mjekësisë dhe Universiteti Teknik i Prishtinës, për shkak të menaxhimit më të lehtë, ngritjes së cilësisë dhe zhvillimit të komponentës së hulumtimeve shkencore.

Sigurimi i autonomisë së plotë për Agjencinë e Akreditimit të Kosovës me përfundimin e Ligjit të AKA-së dhe mbikëqyrja ligjore në zbatimin e kritereve për akreditim dhe licencim të IAL-ve.

Do të vazhdohet në ofrimin e përkrahjes dhe mbështetjes me resurse njerëzore, financiare dhe infrastrukturore për AKA-në që të mund t'i përcjellë standardet evropiane dhe kthimin në dy asociacionet: Regjistrin Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (EQAR) dhe Asociacionin Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ENQA).

Do të vazhdohet me mbështetje përmes bursave për studentët elitare në studimet BA dhe Master dhe do të sigurohet përkrahje me bursa për kandidatë të PHD-së të cilët i ndjekin studimet në 500 universitetet më të mira të botës sipas Listës Shangai. Gjithashtu do të vazhdohet të përkrahen edhe kategori të ndryshme, me grante për hulumtime shkencore në projekte të fushave të ndryshme shkencore dhe me përkrahje financiare për punimet dhe publikimet me impakt faktor, si dhe për publikimin e projekteve dhe monografive shkencore.

Do të punohet në finalizimin e avancimin e statusit të Kosovës në programin e radhës kornizë të BE-së Horizon EU.

Do të punohet fuqishëm në ndërkombëtarizimin, mobilitetin, financimin dhe nxitjes për bashkëpunim ndërkombëtar si dhe diplomave të përbashkëta e programet e integruara.

Aleanca do të punojë dhe shtyjë finalizimin e 6 projektligjeve:

- Projektligji për Tekstet dhe Mjetet Shkollore, Lektyrën Shkollore dhe Dokumentacionin Pedagogjik në Republikën e Kosovës;
- Projektligji për Edukimin Parashkollor – Edukimin në Fëmijërinë e Hershme 0-6 vjeç në Republikën e Kosovës;
- Projektligji për Ratifikimin e Marrëveshjes me Agjencinë Austriake për Zhvillim (ADA);
- Projektligji për Ratifikimin e Plotësimit dhe Ndryshimit të Marrëveshjes së Programit Fulbright;
- Projektligji për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës;
- Projektligji për Agjencinë Kosovare të Akreditimit.

Si dhe do të bëhet vlerësimi i Planit Strategjik të Arsimit PSAK 2016-2021 dhe do të përfundohet hartimi i PSAK 2022-2027 dhe në hartimin dhe zbatimin e Strategjisë së Dixhitalizimit për Dixhitalizimin e Arsimit në Kosovë për periudhën 2021-2026, që nënkupton vënien e teknologjisë në funksion të përmirësimit të mësimdhënies dhe të nxënit, si dhe zhvillimin e kompetencës digjitale tek brezat e rinj.

Riorganizimi i brendshëm i MASHT

Me aprovimin organogramit të ri pas aprovimit të strukturës së brendshme organizative, për herë të parë do të krijohet zyra e komuniteteve në kuadër të MASHT-it, ku secili nga komunitetet jo shumicë do të jetë i përfaqësuar. Janë paraparë edhe 7 departamente si dhe një divizion i veçantë për teknologji informative, që do të ndikonte në rritjen e funksionalitetit të MASHT-it dhe në përmirësimin e shërbimeve të ofruara.

Fondi i ekselencës

Krijimi i fondit të ekselencës për cilësi dhe talente me potencial, të arritura të jashtëzakonshme dhe inovacion në të gjitha fushat, e me theks të posaçëm në shkencat teknike dhe të natyrës.

Koordinimi i donatorëve dhe partnerëve zhvillimor.

Do të punohet në koordinim më të mirë të donatorëve dhe partnerëve zhvillimor për të evituar dyfishimin e aktiviteteve dhe për të siguruar sinergji në funksion të përmirësimit të cilësisë së ofertës dhe shërbimeve arsimore në të gjitha nivelet arsimore dhe të integritimit.

Shëndetësia

Aleanca angazhohet për një sistem shëndetësor që do t'ju sigurojë të gjithë qytetarëve qasje të plotë në shërbime shëndetësore cilësore, pavarësisht nga gjendja e tyre ekonomike.

Që kjo të jetë e mundur, Aleanca do ta rishikoj rritjen ekzistuese të institucioneve shëndetësore dhe do ta përparoj atë. Krahas mbështetjes për mjekësinë familjare, Aleanca do t'ju kushtoj kujdes shërbimeve të emergjencës, atyre të kujdesit në shtëpi, si dhe kujdesit shëndetësor në institucionet shkollore dhe parashkollore. Duke sjellë shërbime subspecialistike në ambulancat e spitaleve rajonale, Aleanca do t'i bëjë këto më lehtë të qasshme për të gjithë, ndërkaq qëndron pranë objektivit që Spitalin e Prizrenit, ta shndërroj në qendër të dytë klinike në Kosovë. Vetë QKUK-ja do të stimulohet që të zhvillojë shërbime të reja, në mënyrë që nevoja për të udhëtuar për këto shërbime jashtë vendit të jetë sa më e vogël.

Cilësia shërbimeve shëndetësore është shtylla kyçe e programit tonë qeveritar. Duke mbikëqyrë cilësinë me të cilën formohen punëtorët shëndetësor në shkolla të mesme dhe fakultete, duke afirmuar procesin e ndarjes dhe të përfundimit të specializimeve, standardizuar procedurat e mjekimit dhe përmes edukimit të vazhdueshëm medicinal, Aleanca do të siguroj që përgatitja profesionale e punëtorëve tanë shëndetësor të jetë sa më e mirë.

Paralelisht me këtë Aleanca do të investoj në infrastrukturë dhe pajisje moderne medicinale si dhe do të siguroj barna dhe material harxhues të mjaftueshëm që institucionet tona shëndetësore të jenë plotësisht funksionale.

Bazën financiare të sistemit do ta përmirësojmë duke rritur buxhetin për shëndetësi, duke ngritur skemë bashkëkohore të sigurimit shëndetësor dhe duke menaxhuar më mirë me mjetet në dispozicion. Duke zhvilluar shërbime të reja dhe duke e ngritur cilësinë e shërbimeve ekzistuese, Aleanca do të fus në sistem një pjesë të konsiderueshme të mjeteve që qytetarët tanë i harxhojnë për mjekim jashtë vendit, ndërkaq llogarisim edhe në mjetet nga donacionet. Në këtë mandat Aleanca do ta shqyrtoj edhe mundësinë e koncesionimit të shërbimeve shëndetësore të shtrenjta, sipas modelit të vendeve të rajonit.

Në të gjitha këto përpjekje, Aleanca e sheh sektorin privat shëndetësor dhe të edukimit si partner të rëndësishëm strategjike. Aleanca do ta promovojë një raport konkurrent dhe të komplementar në mes të këtij sektori dhe sektorit publik, prej të cilit do të përfitojnë qytetarët.

Mjedisi

Degradimi i mjedisit në formën e të gjitha llojeve të ndotjeve, dëmtimi brutal i shtretërve të lumenjve, prerja e pakontrolluar e pyjeve, derdhja e ujërave të zeza në lumenj pa kurrfarë trajtimi, ndërtimet e egra në çdo zonë të Kosovës si dhe shumë dukuri të tjera abuzive në mjedis dhe hapësirë janë të papranueshme.

Aleanca do të angazhohet për rritjen e buxhetit me qëllim të përmirësimit të gjendjes mjedisore dhe e planifikimit hapësinor në Kosovë. Investimet do të fokusohen në trajtimin e ujërave të zeza, në heqjen e deponive të mbeturinave dhe në trajtimin e plotë të tyre, në përfundimin e planeve hapësinore për zonat e veçanta të mbrojtura, në përfundimin e planeve rregullative urbane dhe rurale, për të gjitha komunat e Kosovës si dhe në rehabilitimin e shtretërve të lumenjve dhe të tokës së ndotur.

Partneriteti publiko-privat do të jetë modeli përmes të cilit të gjitha mbeturinat e ngurta do të jenë plotësisht të trajtuara.

Natyra e Kosovës ofron mundësi të shumta për zhvillimin e turizmit dhe veprimtarive ekonomike që ndërliken me të. Do të iniciohen dhe implementohen planet hapësinore në zonat e përcaktuara që mundësojnë zhvillim të turizmit dhe aktivitet ekonomik dhe në të njëjtën kohë këto zona të mbrohen nga degradimi.

Mjedisi i pastër dhe i shëndetshëm si dhe rregulli urban dhe hapësinor, janë të domosdoshme për sigurimin e harmonisë së natyrshme në mes njeriut, mjedisit dhe rritjes së kualitetit të jetës së qytetarëve tanë dhe zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik.



Rinia

Shkollimi adekuat, mundësia për rekreacion dhe sport, shërbimet shëndetësore adekuate, dhe krijimi i vendeve të punës, janë zingjiri që nuk guxon të shkëputet. Rinia jonë nuk do ta kalojë kohën duke u përgatitur për të ardhmen që nuk e ka të qartë. Shumica e dukurive negative buron nga mungesa e shkollimit adekuat. Duhet të krijohet agjenda nacionale për rini të edukuar dhe të shëndoshë. Sistemi i edukimit duhet të forcohet, madje edhe rrënjësisht të reformohet. Shtetit i nevojiten kadro të mirëfillta, që duhet të burojnë nga sistemi publik i edukimit. Shkollat private janë të mirëseardhura, por edhe ato duhet të monitorohen. Por, zhvillimi adekuat i kuadrove duhet të burojë nga sistemi publik, ku shkollat e mesme dhe fakultetet publike, duhet të paraqesin prestigj dhe krenari për nxënësit e studentët. Shteti duhet të krijoj plane strategjike për zhvillimin e rinisë, të krijoj mundësi jo vetëm për shkollim teorik, por edhe atë praktik. Sot kemi me qindra mijëra ekonomistë e juristë të diplomuar, të cilët as që kemi mundësi, as resurse për t'i punësuar. E në anën tjetër nuk kemi punëtorë profesionistë të zanatit, që do të mund ta zhvillonin ekonominë e vogël dhe të mesme. Pra, shteti është ai që u jep drejtim dhe monitorim këtyre zhvillimeve.

Aleanca do të krijojë qartësi për të ardhmen e secilit, aq më tepër do të synojë që rininë tonë ta bëjë pjesëmarrëse në ndërtimin e së ardhmes së vet dhe të shtetit. Aleanca synon që të sigurojë e realizojë:

- ✓ Edukim joformal të garantuar për çdo të ri në nevojë për përgatitje në tregun e punës;
- ✓ Identifikimin e talentëve të veçantë dhe trajtimi institucional i karrierës së tyre;
- ✓ Fond për financim të punësimit të parë të të rinjve;
- ✓ Harmonizimin e plotë të politikave arsimore, shëndetësore, kulturore, të punësimit dhe të zhvillimit në relacion me gjeneratat e reja.

Kultura


Shteti do të garantojë subvencionim për të gjitha lëmitë e artit dhe kulturës në mënyrë që të kompensohet një kohë e gjatë e mungesës së investimeve në këtë fushë. Është interes nacional i Kosovës që trashëgimia kulturore, arti dhe kultura të jenë në dispozicion të publikut. Një gjë e tillë do të garantojë prezantim të denjë të kulturës së Kosovës dhe të ardhura të konsiderueshme financiare. Aleanca synon që të sigurojë e realizojë:

- ✓ Pavarësi financiare për institucionet e kulturës;
- ✓ Rritje të investimeve në kulturë dhe menaxhim të saktë të fondeve për kulturë;
- ✓ Promovim të vlerave dhe traditës tonë;
- ✓ Përkrahje të artistëve të rinj dhe nismave kulturore;
- ✓ Ndërtimi të urave të bashkëpunimit kulturor me vendet tjera;
- ✓ Trajtim të barabartë të të gjitha trashëgimive kulturore;
- ✓ Themelimi të muzeve për vlera të veçanta.

Sport

Kosova ka popullsinë më të re ne Evropë. Kjo strukturë e popullsisë është më e përshtatshme për zhvillimin e talentëve kulminant sportiv. Aktivitetet sportive do të nxiten në mënyrë që të krijohen kushte për afirmim ndërkombëtar. Mbështetja e talentëve do të mundësojë pjesëmarrje të gjerë dhe arritje sportive. Pjesëmarrja e qytetarëve e posaçërisht e të rinjve në aktivitete sportive do të mundësohet me investime sa më të mëdha dhe më në mënyrë adekuate në infrastrukturën sportive. Aleanca synon që të sigurojë e realizojë:

- ✓ Masivizimin e sportit përmes ndërlidhjes së sistemit arsimor me klubet sportive;
- ✓ Seksione sportive për sportet e caktuara nëpër shkolla (veçanërisht gjimnaze);
- ✓ Përcaktimin e sporteve nacionale të Kosovës;
- ✓ Përkrahje financiare për sportet nacionale;
- ✓ Ndërtimin e objekteve të veçanta për sportet nacionale;
- ✓ Rritjen e buxhetit vjetor për federatat sportive.



POLITIKA E JASHTME

Politika e jashtme do të jetë një reflektim i nevojave të vendit, në funksion të ndërtimit, ruajtjes e thellimit të marrëdhënieve me partnerët tanë strategjikë dhe me shtetet tjera, ruajtjes së sovranitetit, integritetit territorial, rendit kushtetues, lirive dhe të drejtave të qytetarëve të Kosovës, brenda dhe jashtë vendit dhe garantimit të sigurisë së saj shtetërore. Republika e Kosovës ka nevojë për një Politikë të Jashtme të qëndrueshme, dinamike dhe në shërbim të interesave shtetërore. Kjo nënkupton që përmes një Politike të Jashtme të unifikuar dhe të përqendruar, të reflektohen politikat e brendshme dhe të plotësohen nevojat strategjike për çarjen e vendit përpara. Prioritizimi i kujdesshëm në Politikën e Jashtme, është themeli i suksesit kombëtar, rajonal e ndërkombëtar të Republikës së Kosovës.

Prioriteti i Aleancës do të jetë forcimi i vazhdueshëm i aleancave strategjike të Kosovës në botë dhe fuqizimi i subjektivitetit ndërkombëtar të shtetit, përmes rritjes së shtrirjes globale dhe influencës rajonale. Mënjanimi i kërcënimeve ndaj interesave shtetërore dhe të sigurisë së Kosovës, sovranitetit territorial, rendit kushtetues dhe vlerave të saj, udhëheqin rendin e prioriteteve. Prioritetet specifike për Politikën e Jashtme do të jenë:

1. Mbrojtja dhe promovimi i sovranitetit shtetëror të Kosovës;
2. Forcimi dhe shtrirja ndërkombëtare e Republikës së Kosovës;
 - a. Forcimi i marrëdhënieve dypalëshe me shtetet njohëse;
 - b. Dinamizmi i marrëdhënieve shumëpalëshe;
3. Promovimi i politikave të sigurisë, fuqizimi i marrëdhënieve dhe anëtarësimi në NATO
4. Forcimi i lidhjes mes shtetit dhe me qytetarëve në diasporë;
5. Dialogu me Serbinë.

Puna efektive dhe e pa ndalur në përmbushjen e këtyre prioriteteve, është baza kryesore e garancisë që Kosova të forcojë pozitën e saj globale, ta përforcojë eksportin e saj në tregjet rajonale e evropiane, ta shtrijë prezencën e saj diplomatike dhe të fuqizojë partneritetin strategjik me aleatët historikë.

Prioritetet e Politikës së Jashtme janë gjithashtu përgjigje ndaj sfidave të përbashkëta të Republikës së Kosovës dhe aleatëve të saj. Agresiviteti i Serbisë ndaj Kosovës dhe rajonit nën prezencën destabilizuese të Rusisë, është sfidë që kërkon gatishmëri emergjente. Radikalizmi ekstrem përbën një sfidë ndërkombëtare dhe lokale me të cilën përballet Kosova, ashtu si edhe gatishmëria për t'u mbrojtur nga sëmundjet endemike. Në përballimin e sfidave në Politikën e Jashtme dhe avancimin në prioritetet me interes për Kosovën, fokus do të jetë bashkëpunimi i ngushtë me aleatin tonë kryesor Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Marrëdhënia historike dhe raporti i rëndësisë strategjike që gëzojmë me SHBA-të është gurthemeli për Politikën e Jashtme të Republikës së Kosovës. Gjithashtu bashkëpunimi i ngushtë me miqtë ndërkombëtarë, me FSK-në, me Agjencinë e Kosovës për Intelgjencë, me

organizatat ku jemi anëtare dhe me ato ku aspirojmë dhe me diasporën tonë të çmuar, janë të rëndësishme për të tejkaluar këto sfida dhe për të mundur një Kosovë ndërkombëtarisht të integruar, të sigurt dhe me potencial të lartë zhvillimor.

1. Mbrojtja e sovranitetit shtetëror të Kosovës dhe konsolidimi i subjektivitetit ndërkombëtar

Mbështetur në Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës, Kushtetutën, dhe me Opinionin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, subjektiviteti i Republikës së Kosovës është i përcaktuar. Integriteti territorial, sovraniteti dhe rendi kushtetues i Kosovës janë parime të konsoliduara, mbi të cilat do të punojmë për promovimin e mëtejshëm të subjektivitetit ndërkombëtar të Republikës së Kosovës.

Njohja nga shtete të reja është prioritet kryesor në këtë aspekt me qëllimin kryesor arritjen e njohjes nga 5 shtetet mos-njohëse të Bashkimit Evropian (Greqi, Spanjë, Rumani, Sllovakia dhe Qipro) dhe shteteve tjera me rëndësi në gjithë botën si Vatikani etj. Do të vazhdojë kontakti me shtetet si Venezuela, Ruanda, Bahamas, St. Vincent dhe Greandinë, për të konkretizuar njohje të reja. Qëllimi kryesor do të jetë njohja nga më shumë vende anëtare të OKB-së, duke synuar anëtarësimin në të ardhmen.

2. Forcimi dhe shtrirja ndërkombëtare e Republikës së Kosovës

2.1 Forcimi i marrëdhënieve dypalëshe me shtetet njohëse

Do të promovohen marrëdhëniet e mira dypalëshe me gjitha shtetet e rajonit, Evropës, dhe botës ku fokus të veçantë do t'i kushtojmë promovimit të marrëdhënieve speciale dhe strategjike me SHBA-të dhe vendet e BE-së. Do të promovohet arritja e partneriteteve strategjike me partnerët tanë kryesorë si SHBA-të, përfshirë: Britaninë e Madhe, Gjermaninë, Italinë dhe Francën. Me rëndësi është konsolidimi i raporteve dypalëshe me shtetet njohëse në secilin kontinent, përmes konkretizimit të marrëdhënieve diplomatikeve si parakusht i avancimit të mëtejshëm të raporteve. Synohet arritja e marrëveshjeve dypalëshe që i hapin rrugë bashkëpunimit konkret, me bazë ligjore të përcaktuara.

Promovimi dhe fuqizimi i marrëdhënieve me Shqipërinë është prioritet parësor për të ndërtuar një marrëdhënie të ngushtë funksionale dhe strategjike. Mbi bazat e fqinjësisë së mirë, do të punohet për lartësimin e marrëdhënieve dypalëshe me vendet fqinje si Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi. Do t'i jepet rëndësi promovimit të pozicionit të Kosovës në rajon dhe potencialit të saj për zhvillim të investimeve dhe tregtisë së jashtme.

2.2 Dinamizimi i marrëdhënieve shumëpalëshe

Roli i Kosovës në arenën ndërkombëtare do të fuqizohet, i pakushtëzuar nga moratoriumi një vjeçar për anëtarësime të reja. Përgatitjet do të jenë intensive për aplikim për anëtarësim në organizata ndërkombëtare menjëherë pas 4 shtatorit 2021. Anëtarësimi i Kosovës në INTERPOL, UNESCO dhe Këshillin e Evropës, do të jenë prioritet kryesor i dinamizimit të marrëdhënieve shumëpalëshe. Anëtarësimi në OKB dhe agjencitë e specializuara të saj, qëndron ende si qëllimi final në këtë aspekt.

Republika e Kosovës do të vazhdojë intensivisht angazhimin në organizatat në të cilat bën pjesë, si rajonale ashtu edhe ato ndërkombëtare. Synimi i pakundërshtueshëm për integrimin e plotë Euro-Atlantik, do të udhëheqë forcimin e rolit të Kosovës në organizatat ndërkombëtare ku bën pjesë. Në këtë aspekt, anëtarësimi në BE dhe NATO do të qëndrojnë si themel i përpjekjeve për dinamizim të marrëdhënieve dypalëshe të Politikës së Jashtme të Kosovës.

Do të intensifikohen përpjekjet për të marrë “TOP LEVEL DOMAIN”, i njohur si Kodi Shtetëror i Internetit.



3. Promovimi i politikave të sigurisë, fuqizimi i marrëdhënieve dhe anëtarësimi në NATO

Synimet armiqësore të Rusisë, përmes qasjes diplomatike, ushtarake dhe asaj të inteligjencës në Serbi, do të trajtohen me kujdes të shtuar bashkërisht me miqtë tanë ndërkombëtar.

Thellimi i dialogut struktural dhe anëtarësimi në NATO do të jetë synim kryesor i Kosovës. Dialogu politik duhet të shihet si një masë e nevojshme për ndërtimin e marrëdhënieve midis NATO-s dhe Kosovës.

Ngritja e Ekipit për Ndërlidhje dhe Këshillim të NATO-s dhe e Ekipit Këshillues të NATO-s në një Zyrë të vetme Ushtarake për Ndërlidhje të NATO-s në Prishtinë, si dhe themelimi i Zyrës për Ndërlidhje të Kosovës në NATO do të trajtohen me prioritet të theksuar.

Në bashkëpunim e bashkëveprim të ngushtë me SHBA-të do të intensifikohen veprimet për hartimin dhe zbatimin e planit të veprimit duke promovuar meritën dhe nevojën për anëtarësimin e Kosovës në NATO.

1. Do të aplikojmë dhe anëtarësohemi në Programin e Partneritetit për Paqe gjatë vitit 2022;
2. Do të sigurojmë pjesëmarrjen e Kosovës në Planin e Veprimit për Anëtarësim (PVA) dhe Procesin e Planifikimit dhe Rishikimit të PpP (PARP) në kuadër të NATO-s;
3. Do të sigurojmë pranimin e ftesës për Kosovën për anëtarësim në NATO, gjatë Samitit të NATO-s në vitin 2024;
4. Do të përmbyllim anëtarësimin e Kosovës në NATO, në vitin 2026.

Me qëllim të realizimit të objektivit tonë strategjik, Aleanca do të ndërmarrë veprimet e mëposhtme:

- Do të sigurojmë stabilitetin e brendshëm politik dhe kultivojmë politikatat e fqinjësisë së mirë;
- Në kuadër të ndërveprimit institucional dhe partneritetit specifik me aleatët strategjik të Kosovës, do të angazhohemi në aktivitetet lobuese dhe avokuse me të gjithë partnerët e brendshëm dhe të jashtëm, shtetëror dhe jo-shtetëror (entitetet që kanë rol ndikues në vendimet politike dhe të sigurisë në nivel nacional dhe ndërkombëtarë), me qëllim të arritjes së mbështetjes dhe përkrahjes së vendeve jo-njohëse në NATO (Spanja, Greqia, Rumania dhe Sllovakia);
- Do të sigurojmë që 2% e BPV-së të destinohet për investime në fushën e mbrojtjes;
- Gjatë vitit 2021 do ta përmbyllim edhe anëtarësimin e Kosovës në Kartën e Adriatikut;
- Do të sigurojmë gatishmërinë dhe pjesëmarrjen e Ushtrisë së Kosovës jashtë vendit, në operacionet në mbështetje të paqes në kuadër të NATO-s.

4. Forcimi i lidhjes mes shtetit dhe qytetarëve në diasporë

Aleanca me diasporën nënkupton një qasje të re në raport me diasporën tonë nëpër botë. Regjistrimi dhe identifikimi i saktë i qytetarëve tanë në diasporë do të mundësojë ndërtimin e një lidhjeje të fortë të shtetit të Kosovës me secilin prej tyre pavarësisht vendndodhjes. Sipas këtij regjistrimi, do të bëhet edhe planifikimi i veprimeve të reja në funksion të interesave strategjike të vendit.

Do të punohet për hapjen e Qendrave Kulturore në vende ku ka përqendrim të madh të diasporës, ku edhe do të organizohet jeta kulturore e arsimore e familjeve të tyre, përfshirë këtu edhe mësimin në gjuhën shqipe. Lidhja e fortë e diasporës me Kosovën do të vlerësohet më tej, në frymë të mirënjohjes për kontributin e pazëvendësueshëm të saj për ndërtimin e vendit. Kjo do të sjellë angazhim të veçantë për lehtësimin dhe mbështetjen e investimeve strategjike të diasporës në Kosovë.

Forcimi i lidhjes mes diasporës së Kosovës dhe shtetit të Kosovës, është nevojë për krijimin e një shteti për të gjithë bashkatdhetarët tanë kudo ndodhen. Republika e Kosovës do të jetë e angazhuar në ndërtimin e një hapësire të përbashkët për zhvillim të qëndrueshëm, duke forcuar rolin e vendlindjes në jetën e diasporës sonë. Përmes angazhimit të trupit diplomatik e konsullor në shërbim të diasporës, do të mundësohet krijimi i një kanali të sigurt të informacionit dhe mbështetjes. Prioritet i rëndësishëm është përmirësimi i platformave aktive për kontakt të menjëhershëm mes diasporës dhe shtetit të Kosovës.

Diaspora jonë ka një peshë të pakrahasueshme në ndërtimin dhe avancimin e Republikës së Kosovës. Forcimi i brendshëm dhe ai ndërkombëtar i Kosovës është fryt i punës së kosovarëve kudo që jetojnë e punojnë. Integrimi i diasporës në strukturën shtetërore të Kosovës është një hap i rëndësishëm për vazhdimin e forcimit të Republikës sonë. Do të mbështetet fuqimisht rritja e rolit të diasporës në institucionet e Republikës së Kosovës edhe për të mundësuar rikthimin në vendlindje.

Si pararojë e një shteti të fortë e të sigurt, Republika e Kosovës është duke investuar në forcimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës, një institucion i hapur për të gjithë bashkëqytetarët tanë. Integrimi në FSK, është një shembull i fortë për forcimin e lidhjes mes shtetit dhe diasporës, përmes mundësimit të shërbimit ushtarak për qytetarët në diasporë. FSK-ja moderne është djep për formimin e bashkatdhetarëve të dedikuar në përparimin e Republikës së Kosovës.

Do të punohet për iniciimin e kuotave të caktuara për qytetarë të diasporës në institucionet e tjera të Republikës së Kosovës. Zëri, përvoja dhe njohuritë e pasura të diasporës sonë janë mbështetje e pakushtëzuar dhe e fortë për forcimin e shtetit tonë. Republika e Kosovës është djepi ynë i përbashkët, jo vetëm si vendlindja jonë por edhe si fryti i punës së bashkëkombësve tanë për krijimin e një shteti të lirë, të pavarur e demokratik.

5. Dialogu me Serbinë

Zgjidhja e raportit me Serbinë në interesin e Republikës së Kosovës, është e mundur vetëm përmes dialogut. Finalizimi i dialogut me një marrëveshje përfundimtare për njohjen e ndërsjellë është parakusht për ruajtjen e paqes në rajon dhe për procesin e integriteteve euroatlantike.

Promovimi i parimeve të pa negociueshme mbi integritetin territorial, rendin kushtetues, sovranitetin dhe karakterin unitar të Republikës së Kosovës, do të jetë kryefjala në raport me dialogun. Kosova ulet e barabartë me Serbinë në dialog, koherente dhe e unifikuar për qëllimet finale të këtij procesi. Do të vazhdojë angazhimi për zbatimin e plotë të marrëveshjeve të deritanishme të arritura në Bruksel dhe Uashington.

Do të promovohet roli kryesor i SHBA-ve si ndërmjetësues në dialog përkrah BE-së, në koordinim për procesin, me synim zgjidhjen përfundimtare të tij. Prioritet është shtyrja përpara e nevojës për definim të objektivave të dialogut, kohëzgjatjes së tij dhe parimeve të pa negociueshme të integritetit territorial dhe sovranitetit të vendit.

Në mënyrë aktive do të punohet për mbrojtjen e pozicionit të Republikës së Kosovës në dialog, duke promovuar të drejtën për trajtim të barabartë në proces. Në këtë mënyrë do të vazhdojë promovimi i respektimit të marrëveshjeve teknike të arritura, veçanërisht mbi lirinë e lëvizjes. Prioritet kryesor mbetet trajtimi në proces i çështjes së personave të humbur dhe varreve masive, duke kërkuar pranimin e të vërtetës nga Serbia, dhe zbardhjen e saj, mbi luftën e vitit 1999.

VLERAT THEMELORE

ALEANCA është parti e qendrës së djathtë dhe parti shtetformuese e Republikës së Kosovës. Aleanca është themeluar në rrethana të veçanta, pas një lufte të gjatë të popullit të Kosovës për liri e pavarësi. Lufta dhe rezistenca e popullit tonë për liri dhe pavarësi, janë vlera të përhershme, unifikuese dhe të mbrojtura nga shteti.

Aleanca përfshinë të gjithë qytetarët e Kosovës, gra e burra të të gjitha moshave, besimeve dhe profesioneve, të cilët besojnë në vlerat dhe vizionin tonë.

Vlerat tona janë të bazuara në traditën tonë dhe të ndërlihdura me shoqërinë dhe shtetin modern. Këto janë vlera të lirisë e solidaritetit, e dinjitetit, e drejtësisë, e zhvillimit dhe konkurrencës.

Si parti e qendrës së djathtë ne krijojmë dhe promovojmë lirinë e individit, lirinë e iniciativës, lirinë e shprehjes, të besimit dhe të konkurrencës në të gjitha fushat e jetës. Ne jemi të bindur se me individ të lirë, do të kemi shoqëri të lirë, shtet të zhvilluar dhe demokraci stabile.

Të drejtat e njeriut bazuar në standardet më të larta ndërkombëtare e të sanksionuara edhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, do të kultivohen dhe mbrohen pa alternativë tjetër.

Prona private është e drejtë themelore e individit, e pacenueshme dhe e mbrojtur nga shteti.

Ne garantojmë ekonomi të tregut të lirë. Shteti krijon dhe rregullon ambient për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik.

Konkurrenca është esenciale për zhvillimin ekonomik të vendit tonë. Me resurset njerëzore e natyrore, vendi ynë bëhet konkurrues edhe me vendet tjera. Ne promovojmë dhe nxisim konkurrencën si brenda vendit, ashtu edhe me rajonin dhe me botën.

Ne punojmë për unitetin shtetëror dhe marrim pjesë aktive në çështjet madhore të kombit dhe në zgjidhjen e çështjeve me interes kombëtar. Aleanca merr përgjegjësi në planin politik dhe në zhvillimin e përsheptuar të vendit.

Dinjiteti përbën kauzën e lirisë sonë, prandaj ai duhet të jetë në përputhje me aspiratat e qytetarëve tanë për jetë më të mirë, për vend më të zhvilluar dhe të ardhme më të begatë.

Solidariteti është vlerë e traditës sonë popullore i kultivuar edhe në kohët moderne. Gjatë gjithë historisë populllin tonë e ka mbajtur gjallë ndjenja e lirisë dhe solidaritetit. Kjo ndjenjë është zhvilluar që nga familja dhe ka marrë përmasa në gjithë shoqërinë tonë. Solidariteti njihet si vlerë dhe përgjegjësi si ndërmjet vete, ashtu edhe ndërmjet gjeneratave. Ne punojmë në ngritjen e solidaritetit mes të gjithë qytetarëve të Kosovës.

Familja është fundament i shoqërisë dhe shtetit tonë. Ne krijojmë kushte për familje të fortë e të shëndoshë dhe krijojmë mundësi lehtësuese për familjet e reja.

Ne punojmë për edukim dhe arsimim cilësor për të gjitha gjeneratat, për mësim gjatë gjithë jetës dhe në funksion të zhvillimit ekonomik të vendit tonë.

Ne ruajmë dhe mbrojmë lirinë e besimit dhe promovojmë vlerat e tolerancës ndërfetare.

Barazia gjinore është e drejtë themelore. Politika e jonë është e orientuar në krijimin e mundësive të barabarta për gratë dhe burrat, vajzat dhe djemtë.

Ne punojmë që të jemi pjesë e familjes së Partive Popullore Evropiane.

Shteti

Kosova është shtet i pavarur, sovran dhe demokratik. Kosova është shtet qytetar i shqiptarëve dhe të tjerëve, të cilët gëzojnë të gjitha të drejtat sipas standardeve më të larta ndërkombëtare.

Ushtria e Kosovës mbrohet lirinë e vendit tonë. Kosova do të anëtarësohet në NATO.

Politika jonë e jashtme bazohet në liri, paqe dhe bashkëpunim në mes të popujve dhe shteteve.

Ne do t'i ruajmë dhe kultivojmë më tutje marrëdhëniet e veçanta kulturore, politike, ekonomike dhe të sigurisë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe aleatët. Synimi ynë është integrimi në Bashkimin Evropian.

Aleanca punon për sistem ekonomik të tregut të lirë i cili mundëson zhvillim të shtetit dhe realizim të aspiratave të secilit qytetar.

Pushteti qendror dhe lokal duhet të funksionojnë në shërbim të qytetarit. Ne synojmë zhvillim të harmonizuar në tërë territorin e Kosovës. Organizimi territorial është komuna dhe pushteti qendror.

Komunat ofrojnë shërbime më afër qytetarëve. Funksionimi i tyre bazohet në një administratë sa më të vogël, por efektive dhe funksionale.

Aleanca synon avancimin e mëtejshëm të Kosovës si shtet demokratik parlamentar, ku Kushtetuta është akti më i lartë politik e juridik, me të cilën rregullohen bazat e funksionimit të shtetit dhe shoqërisë.

Ne garantojmë pavarësinë e pushtetit legjislativ, ekzekutiv e gjyqësor.

Administrata duhet të jetë e vogël, por efektive, moderne dhe e përgjegjshme.

Qeverisja e Kosovës është unike. Territori i Kosovës është i pandashëm.



Prishtinë, janar 2021